

1 E martë, 12 tetor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 --- Fillon në orën 09:31 paradite

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Mirëdita.

6 Znj. Sekretare, ju lutem, paraqitni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
8 mirëdita. Kjo është lëndë me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i
9 Specializuar kundër Salih Mustafës.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si
11 fillim, të prezantohen të pranishmit.

12 Z. Prokuror, kush është i pranishëm për Zyrën e
13 Prokurorisë së Specializuar?

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.
15 Sot për Prokurorinë paraqiten, Alex Whiting, Zëvendësprokuror
16 i Specializuar; Cezary Michalczuk, Prokuror; Silvia D'Ascoli,
17 Ndihmës Prokurore; Julie Mann, Menaxhere e lëndës dhe Filippo
18 De Minicis.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Mbrojtësja e Viktimave.

22 Z. PUES: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.
23 Mirëdita, të gjithëve. Ekipi ynë përfaqësohet nga Njomza
24 Haxhibeqiri, Ndihmës Juriste; Liesbeth Zegveld, si
25 Bashkëmbrojtëse dhe unë, Anni Pues.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Z. avokat i Mbrojtjes.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.

5 Prezantohemi nga unë, Julius Von Bone; Bashkëmbrojtësi im,

6 Betim Shala; Fatmir Pelaj, hetues dhe përkthyes. Dhe në sallë

7 është i pranishëm dhe z. Salih Mustafa.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit.

10 Për procesverbalin, ky gjykim zhvillohet para Trupit

11 Gjykues numër 1. Përpara se të fillojmë me dëshminë e

12 Dëshmitarit me numër 3594, dëshiroj që të trajtoj disa

13 çështje. Së pari shihni këtë dritë të vogël të kuqe në

14 podiumin tonë këtu. Kur është e kuqe, kur ndizet, pra, e kuqe,

15 do të thotë që jemi në seancë publike, çka do të thotë se

16 duhet të tregojmë kujdes për gjërat që themi. Kur është e

17 fikur drita e kuqe, do të thotë që jemi në seancë private. Kjo

18 është një zgjidhje e përkohshme, por na ndihmon të gjithëve ne

19 të shohim se në ç' seancë jemi. Këtë gjë nuk do t'ia shpjegoj

20 dëshmitarit sepse mendoj se është e ndërlikuar, duke pasur

21 parasysh të gjitha elementet, por mendoj se na ndihmon të

22 gjithëve, he për he, deri sa të gjejmë një zgjidhje më të

23 përhershme.

24 Në rregull.

25 Përpara se të fillojmë, dëshiroj t'i drejtohem Mbrojtjes.

1 Z. Von Bone, të fund të seancës, të martën, na sollët në
2 vëmendje se fotografitë që u treguan janë botuar në gazeta, në
3 televizion, online e kështu me radhë, ju lutem, a mund të
4 shtjelloni përse e ngritët këtë çështje.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Sepse unë mendoj, sepse të gjithë
6 në Kosovë edhe dëshmitarë të cilët do të paraqiten në sallë,
7 mund t'i shohin këto fotografi edhe kjo mund të ndikojë në
8 dëshminë e tyre.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
10 dëshironi që të bëni ndonjë parashtrim lidhur me këtë?

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë, thjesht e ngrita si çështje
12 këtë për personat përkatës. Në përgjithësi, nuk mendoj se
13 është gjë e mirë, që fotografi që përdoren për të identifikuar
14 disa persona nga ana e dëshmitarëve, në një moment të caktuar,
15 janë të publikuara që më përpara në televizion, në gazeta e
16 kështu me radhë, sepse normalisht personat mund të ndikohen
17 prej kësaj. Mund t'i kërkojnë këto fotografi t'i shikojnë dhe
18 nëse nuk ka fotografi të tjera që u tregohen dhe nëse dikush
19 jep dëshmi në gjykim dhe këto janë dokumentet të cilat i
20 tregohen dëshmitarit, ka shumë mundësi që dëshmitari t'i ketë
21 parë më përpara dhe të jetë përgatitur, si të thuash, për
22 dëshminë në një mënyrë të caktuar. Ose, kjo, mbase, nuk është
23 dëshmitari në vetvete por mediat që e publikojnë, ku njerëzit
24 reagojnë përmes mediave sociale, unë mendoj se kjo mund të
25 ndikojë në proces, në procesin gjyqësor. Dhe ne mund të

1 arrijmë në një konkluzion më pas. Po, hë për hë, po e ngremë
2 si çështje që njerëzit ta dinë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse
4 ju ndoqa mirë, ju nuk keni kundërshtim ose keni kundërshtim?
5 Është më mirë që të jeni i qartë në sallë, z. Von Bone, se
6 çfarë dëshironi që të bëjnë të tjerët. Sepse vetëm fakti që e
7 ngrini si çështje, mbase nuk mjafton.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Po të ishte për mua, unë nuk do
9 të doja që njerëzve t'u tregohen fotografi për të identifikuar
10 dikë ndërkohë që kjo mundësi është krijuar prej shumë kohësh
11 më parë. Po të ishte në dorën time, nuk do t'ua tregoja këto
12 fotografi dëshmitarëve dhe mendoj se nuk është gjë e urtë që
13 t'u tregohen fotografi që të cilat janë publikuar.

14 Ky është këndvështrimi. Mendoj që nuk është mënyrë e mirë
15 për ta pyetur dëshmitarin, "A mund të identifikoni përmes
16 këtyre tre, katër, pesë apo gjashtë njerëzve dikë", nëse këta
17 persona janë identifikuar gjerësisht tashmë në Kosovë në
18 fotografitë që janë shfaqur sepse njerëzit, siç e thashë, [e]
19 komentojnë për këtë. Persona të tjerë, mbase, të cilët
20 intervistohen, nuk e di, në programe televizive, në Talk Show
21 dhe nëse e shohin këtë pastaj njerëzit, kjo nuk do të ishte e
22 dobishme për konstatimin e së vërtetës, në kuptimin që, nëse
23 dikush duhet të identifikojë dikë, atëherë unë nuk mendoj se
24 kjo është mënyra e duhur e identifikimit të këtij personi.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Von Bone, të enjten, ju e bëtë një vërejtje më të
2 përgjithshme. Trupi Gjykues nuk e kishte shumë të qartë se për
3 çfarë e kishit fjalën. Siç e kuptoj unë tashti, ju po thoni
4 se: Mendoj se nuk është identifikimi i duhur, pra, nuk mund të
5 bëhet pra, identifikimi i duhur. Së dyti, siç e kuptoj unë,
6 tani ju po flisni për fotografi të cilat janë shfaqur por ju,
7 në veçanti, e keni fjalë për fotografitë me persona në to.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Për të qenë i singërtë, jo vetëm
9 me persona në të. Por është edhe kompleksi, shtëpia, në
10 veçanti, që kemi parë apo për të cilat u janë bërë pyetje
11 personave. Kjo gamë fotosh -- nuk i takon Mbrojtjes që t'i
12 bëjë pyetje Trupit Gjykues. Nëse Trupi Gjykues ka pyetje të
13 veçanta dhe i tregon disa fotografi të caktuara dëshmitarit,
14 është tërësisht në dorë të Trupit Gjykues. Unë, thjesht, desha
15 që ta ngre këtë çështje në mënyrë që të jemi të ndërgjegjshëm
16 për faktin se këto fotografi janë publikuar gjerësisht në
17 lajme dhe në media të tjera të Kosovës. Ky proces gjyqësor
18 ndiqet drejtpërsëdrejti në Kosovë. Kështu që dukshëm ka një
19 interes të madh. Në ato periudha që unë kam qenë në Kosovë, ka
20 qenë një prej lajmeve më të para në emisionet e lajmeve, të
21 themi, ky proces gjyqësor. Pra, ka një interes sa i takon
22 transmetimit të këtij gjykimi. Dhe mediat e lajmeve bëjnë
23 punën e tyre, sigurisht, kjo punë mund të ndikoj; tek personat
24 të cilët do të dëshmojnë ose janë duke dëshmuar.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për

1 të qenë më specifik;, nuk është vetëm Trupi Gjykues që paraqet
2 fotografi lidhur me kompleksin. Këtë gjë e bën edhe ZPS-ja. Ju
3 përmendët Trupin Gjykues, po mendoj që bëhet fjalë për diçka
4 më të gjerë se kaq.

5 Por ajo që dëgjova prej jush, pra, siç e kuptova,
6 aktualisht, ju nuk po bëni parashtrime?

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, hə për hə, nuk duam që të
8 arrijmë në ndonjë konkluzion për këtë tani për tani, thjesht,
9 duam t'ua rikujtojmë të gjithë pjesëmarrësve këtë çështje dhe
10 konkluzionet do t'i nxjerrim në një moment më të vonë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
12 qartë.

13 Ajo që dua të përmend tani është se të gjitha
14 fotografitë, të cilat i janë treguar dëshmitarëve, nuk kanë
15 qenë nuk janë treguar asnjëherë publikisht. Gjithçka që u
16 tregohet dëshmitarëve nuk shfaqet publikisht. E vetmja gjë që
17 i është treguar publikut janë fotografitë të cilat janë
18 shfaqur gjatë deklaratave hyrëse, në fillim të gjykimit. Këto
19 fotografi po. Dhe këto fotografi -- për këto fotografi
20 paraprakisht Mbrojtja është informuar se do të shfaqen dhe ju
21 mund të kishit shprehur kundërshtim për shfaqjen e tyre. Për
22 procesverbalin e them këtë, për të qenë të qartë se ku
23 qëndrojmë.

24 Gjithçka që është në media ka ardhur nga dita e
25 deklaratave hyrëse dhe nuk ka dalë, le të themi, nga dëshmitë

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 e dëshmitarëve që i dëgjojmë këtu në sallë, është diçka të
2 cilën e kemi diskutuar në një moment të mëparshëm dhe, që nuk
3 ka ndryshuar. Mendoj që është e rëndësishme që t'jua them
4 këtë.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Po nëse mundem, e nderuar
6 Gjykatëse, fakti që nuk kemi shprehur kundërshtim asokohe,
7 është në të kegen e Prokurorisë, pra, nëse dëshmitarët
8 influencohen apo jo, pra, kjo është në dorën e Prokurorisë.
9 Dhe është Prokuroria, ajo, e cila vendos sesi do t'i paraqesë
10 provat e veta, i takon Prokurorisë që të vendos se çfarë është
11 e nevojshme apo e panevojshme që të tregohet. Por, unë, ne
12 mendojmë se, siç e kemi parë, që të njëjtat fotografi të cilat
13 ka treguar Trupi Gjykues i janë paraqitur dhe dëshmitarëve.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
15 këtë e thatë dhe më përpara, e mbajtëm shënim z. Von Bone. Por
16 për mua është e rëndësishme që të shprehemi dhe ne se ku
17 qëndrojmë.

18 Shoh që edhe ZPS-ja kërkon fjalën. Do t'jua jap z.
19 prokuror, fjalën.

20 Por, aktualisht, z. Von Bone, vë re se ju nuk po bëni
21 parashtrime dhe konkluzionet do t'i bëni në një moment të
22 mëpasshëm.

23 Z. Prokuror, keni fjalën.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
25 Gjykatëse.

1 Ne filluam me një problem dhe pastaj dolëm në, pra, në
2 probleme të ndryshme. Mendojmë se ka dallim midis fotografive
3 të cilat përdoren për identifikim nga Trupi Gjykses dhe të
4 tjera nga ato që përdor Prokuroria.

5 Unë mendoj se, së dyti, që Avokati duhet - më falni - që
6 Trupi Gjykses mund ta zgjidhë këtë problem duke i pyetur
7 dëshmitarët nëse i kanë parë këto fotografi apo jo më përpara,
8 sepse, të nderuar Gjykatës, aktualisht, flasim në mënyrë
9 hipotetike, nuk e dimë nëse bëhet fjalë për fotografi që
10 tregon Trupi Gjykses apo Prokuroria.

11 Disa fotografi pastaj që Prokuroria i përdor këtu janë
12 përdorur edhe në intervistat me dëshmitarin me ZPS-në.

13 Unë, -- nuk mendojmë se ka ndonjë gjë të papërshtatshme
14 në momentin kur janë treguar këto fotografi dëshmitarit më
15 përpara. Avokati Mbrojtës e kishte mundësinë që ta sqaronte
16 këtë çështje. Këto fotografi mbeten ose jo të vlefshme, kjo
17 konstatohet nga Trupi Gjykses, po ky është parashtrimi ynë në
18 formë të përmbledhur, të nderuar Gjykatës.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Znj. Mbrojtëse e Viktimave, keni diçka për të thënë për
22 këtë çështje.

23 Z. PUES: [Përkthim] Faleminderit. Jo, nuk kemi
24 parashtrime shtesë për këtë çështje.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Z. Von Bone, faleminderit për sqarimin tuaj. Besoj e
3 kuptoni edhe atë që thotë Trupi Gjykses, që të enjten që
4 shkoi, për ne ishte disi e paqartë se çfarë duhet të bënim me
5 ato që thatë ju. Kështu që herës tjetër, nëse keni ndonjë
6 problem, ju lutem, na e paraqisni sepse për këtë jemi këtu.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë nuk e
8 dija nëse Trupi Gjykses ishte në dijeni të qarkullimit të
9 këtij materiali në mediat e lajmeve. Ky është problemi. Në
10 përgjithësi, siç e thashë, Mbrojtja, hë për hë, nuk do të bëjë
11 gjë por, thjeshtë, duam që të sigurohemi që të gjitha palët të
12 jenë në dijeni të kësaj. Çfarëdo lloj gjëje pastaj që mund të
13 bëjmë ne me këtë është në përgjegjësinë personale të secilës
14 palë. Por nga këndvështrimi i Mbrojtjes, unë dua të them se
15 nuk jemi të kënaqur me faktin që gjërat që janë të publikuara
16 gjerësisht përdoren në Gjykatë mbase për të arritur ndonjë
17 konstatim pa e ditur, pa e ditur që janë të publikuara
18 gjerësisht.

19 Edhe, një herë, dua që të them, që të them që ky gjykim
20 transmetohet drejtpërsëdrejti. Merr shumë vëmendje në lajmet
21 në Kosovë edhe mediat bëjnë hetimin e tyre. Kanë edhe ato
22 interes. Kështu që nga kjo perspektivë, duhet që të mbajmë
23 parasysh edhe këtë. Kështu që, sa i takon konstatimit të së
24 vërtetës, mendoj që është e rëndësishme që ndonjëherë të
25 tregohemi të kujdesshëm apo të jemi të vetëdijshtëm për disa

1 gjëra.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 Von Bon, Trupi Gjykses është tërësisht i vetëdijshëm për këtë.

4 Është një prej gjërave më të rëndësishme për të cilat ne e

5 kemi -- pra, është një nga gjërat më të rëndësishme që ta

6 informojmë popullin në Kosovë se çfarë ndodhë këtu në sallë,

7 pra, është një nga prioritetet tona.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe nëse mundem, së fundi, nëse

9 mund të them diçka për këtë. Është, sigurisht, e rëndësishme

10 që njerëzit në Kosovë të jenë në gjendje ta ndjekin procesin.

11 Për këtë s'kam kundërshtim por, thjeshtë, dua të sigurohem që

12 të mos ketë një gjykim në media në Kosovë për klientin tim,

13 sepse unë e mbroj klientin tim dhe nuk dua që ta kemi një

14 ndikim të parregullt.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

16 Von Bone, ju po përsërisni veten. Është shumë e qartë, ne

17 mendojmë që është shumë e rëndësishme që ky proces të

18 transmetohet.

19 Mirë. Në rregull.

20 Tani, z. Prokuror, keni fjalën.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

22 Gjykatës. Shumë shkurt do flas. Unë desha që të sigurohem që

23 të mos vijojmë në bazë të prezumimit se fotografitë e

24 përdorura në këtë gjykim dihen nga publiku apo janë publikuar

25 gjerësisht. Unë do kërkoja që, nëse ndonjë prej palëve apo

1 Trupi Gjykses, ka ndonjë dyshim, t'i bëhet pyetje dëshmitarit
2 në mënyrë që sa herë që dëshmitarit t'i tregohen fotografi të
3 kompleksit apo të personave të dyshuar apo të tjerë. Unë e
4 kuptoj që ky proces transmetohet, por përdorimi i mjeteve
5 pamore është një instrument që përdoret nga palët dhe nga
6 Trupi Gjykses për të konstatuar të vërtetën. Dhe ka mënyra të
7 përshtatshme për të sqaruar nëse dëshmitari e njeh atë
8 fotografi apo jo.

9 Faleminderit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
11 Faleminderit.

12 Z. Von Bone, ka ndonjë gjë që doni të përgjigjeni për
13 këtë?

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës, mendoj
15 se u diskutua tashmë gjerësisht.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
17 Faleminderit.

18 Por është e rëndësishme që u sqarua në mënyrë që të na
19 ndihmojë me ecjen përpara të këtij procesi. Mirë.

20 Të kalojmë tani tek dëshmia e Dëshmitarit me numër 3594.
21 Ju lutem, shoqërohëni dëshmitarin të hyjë në sallë.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, premtoj që
23 është hera e fundit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
25 ka nevojë të premtoni që është hera e fundit. Nëse është diçka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 12

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 me rëndësi, ju lutem.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë në seancë
3 private, ju lutem, për disa parashtrime të shkurtra.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
5 rregull.

6 Znj. Sekretare, ju lutem, të kalojmë në seancë private.

7 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull. Dhe për të gjithë pjesëmarrësit, drita e kuqe është
11 fikur tashmë.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duam të
13 informojmë Trupin Gjykes se gjatë takimit me këtë dëshmitar,
14 ai sërish ka shprehur shqetësime lidhur me identitetin e tij
15 dhe për faktin se është [REDAKTUAR] që
16 ka lidhje me këtë çështje gjyqësore. Kështu që, do të bëjmë
17 çmos që dëshminë e tij ta japim sa më shumë në seancë publike.
18 Por, druaj se me këtë dëshmitar, me lejen e Trupit Gjykes, do
19 të na duhet që të qëndrojmë më gjatë në seancë private nga
20 ç'jemi mësuar zakonisht.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit, z. Prokuror. Është diçka të cilën Trupi Gjykes,
23 ne si Trup Gjykes e kemi diskutuar tashmë me njeri-tjetrin,
24 sigurisht, prioritetin e kemi që të jemi sa më shumë në seancë
25 publike por kemi edhe masa mbrojtëse të cilat na duhet t'i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 13

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 respektojmë. Unë i kam vërejtur përpjekjet që kanë bërë palët
2 dhe Mbrojtësja e Viktimave javën që shkoi që të zhvillojmë sa
3 më shumë nga seanca, në seancë publike dhe për këtë ju
4 falënderoj. Por, sigurisht, që do të veprojmë sipas
5 dëshmitarit.

6 Në rregull.

7 Znj. Sekretare, ju lutem na riktheni në seancë publike.

8 Z. Prokuror, e mbajtëm shënim atë që thatë.

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
11 jemi tani në seancë publike.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
13 rregull. Ju lutem, shoqërojeni dëshmitarin të hyjë në sallë.

14 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Dëshmitar, mirëmëngjesi.

17 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
19 se erdhët në Dhomat e Specializuara. Më dëgjoni?

20 DËSHMITARI: Po. Ju dëgjoj mirë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si
22 jeni?

23 DËSHMITARI: Mirë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit, z. Dëshmitar.

1 Sot do të fillojmë me dëshminë tuaj, por përpara kësaj,
2 kam disa gjera për të thënë.

3 Fillimisht dëshiroj të shpjegoj masat mbrojtëse që janë
4 miratuar për dëshminë tuaj këtu.

5 Ju është caktuar një pseudonim, që do të thotë se nuk do
6 t'jua përmendim kurrë emrin tuaj të vërtetë, por do t'ju
7 thërrasim vetëm me fjalët "Z. Dëshmitar". Në mënyrë që publiku
8 mos t'jua marrë vesh emrin.

9 Gjithashtu dëshminë do ta jepni me ndryshim të pamjes dhe
10 të zërit, që do të thotë se askush jashtë kësaj salle nuk mund
11 t'jua shohë apo t'jua dëgjojë zërin e vërtetë.

12 Pyetjet dhe përgjigjet që nuk jua zbulojnë identitetin do
13 të bëhen në seancë të hapur, seancë publike, çka do të thotë
14 se publiku mund të dëgjojë se çfarë thuhet këtu në sallë. Në
15 rregull? Por pyetjet që kërkojnë përshkrim të çfarëdo gjëje që
16 ka lidhje konkretisht me ju apo që kërkojnë përmendjen e
17 fakteve që mund t'jua zbulojnë identitetin, do të bëhen në
18 seancë private, kjo do të thotë se nuk do të ketë transmetim
19 dhe se askush jashtë kësaj salle nuk mund të dëgjojë se çfarë
20 thuhet këtu në sallë.

21 Nëse gjatë seancave të hapura, thuhet ndonjë gjë, nga e
22 cila mund të identifikoheni, këtë informacion do ta mbrojmë.
23 Dëshmia transmetohet me vonesë, jo menjëherë, kështu që ne
24 mund t'i heqim informacione të tilla nga transmetimi që do të
25 shohë dhe do të dëgjojë publiku si edhe nga procesverbali

1 publik i procesit.

2 Z. Dëshmitar, a janë të qarta masat mbrojtëse që sapo
3 shpjegova?

4 DËSHMITARI: Shumë të qarta dhe s'e kam problem këtë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e
6 ngre pak volumin e dëgjueseve të mia që të dëgjoj më mirë.

7 Faleminderit, z. Dëshmitar.

8 Sigurisht, të gjithë ne, duhet t'i respektojmë këto masa
9 mbrojtëse dhe të tregojmë vëmendje maksimale gjatë bërjes së
10 pyetjeve që të shmangim nxjerrjen në seancë të hapur të
11 informacioneve konfidenciale.

12 Palëve u rikujtoj, se ky gjykim zhvillohet në seancë të
13 hapur, nëse palët apo Mbrojtësja e Viktimave nuk kërkojnë
14 kalimin në seancë private ose të mbyllur, ose nëse nuk vendos
15 Trupi Gjygues, ju rikujtoj palëve dhe Mbrojtëses të Viktimave
16 të ndjekin procedurën për të kërkuar redaktimin në Gjykatë, po
17 kështu edhe për të mos folur shumë shpejt.

18 Z. Dëshmitar, tani po ju drejtohem juve. Jeni thirrur të
19 jepni dëshmi para Dhomave të Specializuara për ta ndihmuar
20 Trupin Gjygues të marrë vendim. Pas deklaratës solemne nga ju
21 për të thënë të vërtetën, do t'ju bëjnë pyetje përfaqësuesit e
22 Prokurorisë, të cilët janë të ulur në këtë anë; pastaj
23 përfaqësuesit e Mbrojtjes së Viktimave që janë pranuar të
24 marrin pjesë në këtë proces, që janë të ulur atje; dhe, pastaj
25 nga Avokati Mbrojtjes i z. Mustafa; dhe në fund nga Gjykatësit

1 anëtarë të Trupit Gjykues.

2 Dua jap disa udhëzime sesi t'u përgjigjeni pyetjeve.

3 Z. Dëshmitar, ju lutem, dëgjojeni me vëmendje secilën
4 pyetje, nëse nuk e kuptoni, lirisht, mund të kërkonti që pyetja
5 të përsëritet. Duam të na thoni të vërtetën dhe të na tregoni
6 se çfarë keni parë, çfarë keni përjetuar, çfarë keni dëgjuar,
7 çfarë keni ndjerë ju vetë, nëse nuk e keni parë apo dëgjuar ju
8 vetë por e keni marrë vesh ndryshe, na e thoni që është kështu
9 dhe na e tregoni si e keni marrë vesh. Mbase nuk ju kujtohen
10 të gjitha hollësitë edhe kjo është e kuptueshme, nuk ka asgjë
11 të keqe nëse thoni "Nuk e di" apo "Nuk më kujtohet".

12 Z. Dëshmitar, i kuptuat të gjitha këto?

13 DËSHMITARI: [Nuk dëgjohet].

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka
15 edhe disa këshilla praktike që dua t'jua jap, gjithçka që
16 thuhet këtu përkthehet nga përkthyesit që janë aty lart dhe
17 raportohet. Pra, ka rëndësi që kur të flasësh, të flasësh
18 përpara mikrofonit, të flasësh qartë dhe me ngadalë, me qëllim
19 që përkthyesit të kenë mundësi ta bëjnë si duhet punën e tyre.
20 Dhe duhet të fillosh të përgjigjesh vetëm kur personi që të
21 bën pyetjen ta ketë përfunduar pyetjen. Kjo është shumë e
22 rëndësishme. Pra, mund të numërosh me mendje deri në numrin
23 pesë përpara se të fillosh të përgjigjesh.

24 Në qoftë se ke ndonjë pyetje, në qoftë se ke nevojë për
25 ndonjë pushim apo ke nevojë për ndihmë, ngri dorën dhe unë e

1 kuptoj që do të thuash diçka dhe pastaj bëjmë atë që duhet
2 bërë. Në rregull?

3 I kuptuat të gjitha këto që ju thashë?

4 DËSHMITARI: [Nuk dëgjohet]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
6 mirë.

7 Siç bëj me të gjithë dëshmitarët, tani, do të kërkoj që
8 të lexosh deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Dhe të
9 kujtoj që është vepër penale, si mbas juridiksionit të
10 Gjykatës, të japësh dëshmi të rreme.

11 E kupton këtë?

12 DËSHMITARI: [Nuk dëgjohet]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
14 mirë.

15 Të lutem, ndihmoje Dëshmitarin për të thënë të vërtetën.
16 Jepja deklaratën.

17 Lexoje, të lutem, tekstin që ke përpara.

18 DËSHMITARI: Shumë për rëndësinë e dëshmisë time dhe
19 përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do ta them
20 të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk
21 do të mbajë të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani je nën betim për të thënë të
24 vërtetën.

25 Tani mund të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 3594, së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 18
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 pari fillon Prokuroria.

2 Keni gjithsej pesë orë afërsisht për pyetjet. Dhe
3 informoni Trupin Gjykses nëse keni ndonjë ndryshim në këtë
4 planifikim.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do të bëjmë maksimumin dhe do
6 t'ju njoftojmë në qoftë se kemi ndonjë ndryshim.

7 A mund të kalojmë në seancë private, ju lutem, meqenëse
8 do ta pyesim dëshmitarin për hollësitë, detajet personale?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Sekretare, të lutem, të kalojmë në seancë private.

11 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private,
13 të nderuar Gjykatës.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Prokuror, keni fjalën.

17 DËSHMITARI: W03594

18 Marrje në pyetje nga Z. De Minicis:

19 PY. Mirëmëngjesi, Z. Dëshmitar.

20 PË: Mirëmëngjes.

21 PY. Je gati për të filluar?

22 PË: Po.

23 PY. Të lutem, na thuaj si të quajnë? Me emër mbiemër për
24 procesverbal.

25 PË: [REDAKTUAR]

1 PY. Kur ke lindur dhe në ç'vend ke lindur?

2 PË: Kam lind më [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 PY. Kur filloi lufta në Kosovë në 1998-n, me çfarë pune je
5 marrë?

6 PË: Jam marrë [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 PY. Z. Dëshmitar, a mund t'i shpjegosh Trupit Gjykses se
12 çfarë është [REDAKTUAR] që sapo e përmende?

13 PË: [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 PY. Ku e kishit qendrën?

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 20

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 PË: Prej fillimit të luftës në Drenicë afër 1998-1999 kam
5 qenë vazhdimisht në atë zonë. Po mendoj çdo ditën e dytë ose
6 të tretë edhe kam pasë kontakt me të gjithë pjesëtarët e UÇK-
7 së në zonën e Drenicës, të Malishevës, të Rahovecit dhe zonave
8 tjera.

9 PY. A diskutoje me ta problemet që kishin, nevojat që kishin

10 [REDAKTUAR] -- ç'a lloj diskutimesh

11 kishe me këto - të mbaroj pyetjen, të lutem - me këta anëtarë
12 të UÇK-së?

13 PË: Në çdo zonë e kishte komisionin e vet të komunës.

14 Skënderaj e kishte. [REDAKTUAR] në Skënderaj [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR] Duhet të ceku se në prag të luftës [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR] Prej të gjithave

17 zonave [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 PY. Z. Dëshmitar, gjatë luftës, ti vetë a ke qenë ndonjëherë
20 anëtar i UÇK-së?

21 PË: Jo, nuk kam -- ata më kanë shpallë -- Brigada [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR] jam si pjesëtar i brigadës.

23 PY. Kur të kanë shpallë anëtar - ja një minutë të mbaroj, të
24 lutem - kur të kanë shpallë anëtar të Brigadës [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 PË: Pas luftës, kur është bërë vlerësimi i pjesëtarëve ose
2 veteranëve.

3 PY. Z. Dëshmitar, ke qenë në Prishtinë kur NATO bombardoi
4 qytetin në 24 mars 1999?

5 PË: Po.

6 PY. Dhe pasi filloi bombardimi, qëndrove në Prishtinë apo u
7 largove prej saj?

8 PË: Pasi filloi bombardimi, meqenëse në zonën e Drenicës nuk
9 kemi mujtë me lëvizë zona e Gollakut, si e quajtshim ne,
10 Mramori, Zllashi, ato zona, ishin plot njerëz që ishin
11 shpërngul nga Prishtina. Dhe me qëllimin ma të mirë patëm
12 shku, patëm ndihmu diçka se ishte krizë e madhe dhe e bukës
13 dhe të gjitha gjërave elementare për jetë, [REDAKTUAR]
14 te një mik i imi.

15 PY. A të kujtohet afërsisht data kur shkove [REDAKTUAR]?

16 PË: Kam shku dikund më 28 mars. Ashtu ka qenë.

17 PY. Kur vajte në [REDAKTUAR], ku qëndrove?

18 PË: Kam qëndru tek një mik i imi [REDAKTUAR] Mik familjar.

19 PY. Nga [REDAKTUAR] vazhdove të punosh - ja një minutë - pra,
20 duke u marrë [REDAKTUAR], siç bëje përpara nga
21 Prishtina? Bëre të njëjtën gjë, pra?

22 PË: Jo, nuk kishte mundësi. Po kam lëviz. Ishte një zonë aty,
23 një zyre, ku ata e kishin shpallë [REDAKTUAR] si Zyrë
24 Emergjente për ndihmë fshatarëve që kishin shku dhe aty më
25 afrun, dikun më [REDAKTUAR]. Meqenëse kishim [REDAKTUAR]

- 1 [REDAKTUAR] Në
- 2 Kamenicë kemi shku dhe kam kërku që ta lajmërojnë [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR], në atë kohë ishte [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 PY. Këta njerëzit e zyrës [REDAKTUAR], këta ishin po ashtu
- 8 anëtarë të UÇK-së që të thanë -- që u kërkove të kontaktojnë
- 9 [REDAKTUAR]?
- 10 PË: Unë besoj se edhe ata e kishin një njësi të vetën
- 11 [REDAKTUAR] që si të UÇK-së, fshati si fshat.
- 12 PY. Pra, ti i the Trupit Gjykues që u kërkove atyre njerëzve
- 13 [REDAKTUAR] të kontaktonin [REDAKTUAR] që e quanin [REDAKTUAR]
- 14 Këta njerëzit pranuan ta kontaktonin [REDAKTUAR] në emër tënd?
- 15 PË: Kështu më thanë se "do ta kryejmë këtë punë".
- 16 PY. Pasi të thanë që do ta kontaktonin [REDAKTUAR], çfarë
- 17 bëre ti?
- 18 PË: Asgjë. Unë shkova ku isha në atë familjen edhe kam pritë
- 19 që ata të më lajmërojnë.
- 20 PY. Pra, dëgjove të thanë gjë këta njerëzit lidhur me
- 21 kërkesën tënde, të dhanë ndonjë përgjigje [REDAKTUAR]?
- 22 PË: Jo. Jo. Tek më 4 kanë ardhë. Më [REDAKTUAR] diku në
- 23 mesditë, nuk më kujtohet, kanë ardhë tre vetë dhe më kanë
- 24 kërkuar në atë familjen ku isha tuj banu. Kanë thënë "Na duhet
- 25 [REDAKTUAR]". Kur kam dalë kanë qenë tre vetë me rroba të UÇK-

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 23

1 së, pa maska, s'kanë pasë maska, më kanë thënë "Po të thirrë
2 [REDAKTUAR]". Se unë kam lyp sqarim "Çka doni?" Më kanë thënë
3 "[REDAKTUAR] po të thirrë". Edhe unë duke menduar se një ditë
4 përpara e kisha bisedu [REDAKTUAR] i kisha çu fjalë
5 [REDAKTUAR] e quajshin [REDAKTUAR], kam mendue që unë po shkoj
6 te [REDAKTUAR]. Po më thirr [REDAKTUAR] që kishin ardhë për
7 fshatin Mramor.

8 PY. Të shohim nëse të kuptova drejtë. Ti ishe në shtëpi dhe
9 tre njerëz të veshur me uniformë erdhën dhe të thanë që "Të
10 kërkon [REDAKTUAR]". Meqenëse ti kishe kërkuar të takoheshe me
11 këtë. Kështu? Këtë po thua?

12 PË: E vërtetë, këtë.

13 PY. A mund t'i thuash Trupit Gjykues se çfarë ndodhi më pas?

14 PË: Kam hip në veturë. Një veturë, atëherë zakonisht ishin të
15 tipit, të vjetra, Niva quheshin, nuk e di dhe kemi udhëtuar
16 kur e kemi kaluar [REDAKTUAR] nuk e kam ditë se ku po shkojmë.
17 Ata tanë gjatë kohës gjatë udhëtimit janë sjellë në mënyrë
18 njerëzore me mu. I kam qitë cigare, më kanë qit cigare edhe
19 unë s'i kam pyet fare duke menduar se ata po më dërgojnë te
20 [REDAKTUAR].

21 A mund ta vazhdoj?

22 PY. Patjetër.

23 PË: Rrugës duke udhëtuar në një zonë malore, binte shi i madh
24 dhe në një moment kemi mbetë në baltë vetura. Kam dalë së
25 bashku i kemi ndihmuar me e shty atë veturë.

1 Unë në brez kisha një revole me vete, [REDAKTUAR]
2 [REDAKTUAR], që në qoftë se më ndal
3 policia, meqenëse udhëtonim gati çdo ditë, më ndalon policia
4 serbe, bile ta paguaj vetveten, mos ju bie në dorë.

5 Njëri prej atyne tre vetëve, që ishim së bashku, më ka
6 thënë "A ke armë me vete?. I kam thënë "Po". "A ka mundësi me
7 e pa?" Ja kam afriu. Edhe më ka thënë "Qenka shumë e mirë, a
8 mund ta mbaj pak?".

9 Unë kam mendu se kur po shkojmë atje ma jep revolen, gjë
10 që s'ka ndodhë sot edhe atë ditë s'ma kanë kthy revolen.

11 PY. Dhe kjo ndodhi kur ti po ndihmoje që ta shtyje makinën të
12 dilte nga balta?

13 PË: Ashtu, kur kam qenë jashtë.

14 PY. Më në fund e nxorët nga balta makinën dhe vazhduat
15 rrugën?

16 PË: Qemë katër vetë ishim.

17 PY. Dhe pasi u futët përsëri në makinë, ku shkuat?

18 PË: Shkuam në një fshat, që nuk e dija që është, pastaj e kam
19 marrë vesh që është Zllash. Në atë moment nuk e kam ditë.

20 Është ndal vetura dhe këta më kanë thënë "Prit pak derisa ta
21 lajmërojmë [REDAKTUAR]".

22 Mbas pesë-gjashtë minutave kanë ardhë dy vetë të maskum
23 me maska kanë qenë, fytyrën me maskë edhe më kanë dërgu -- unë
24 kam mendu që po më çojnë në ndonjë zyrë me kontakt

25 [REDAKTUAR], ata më kanë fut pa kurrë farë sqarimi vetëm e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 25

1 kanë hap derën edhe e kam pa veten nën një ahër të kafshëve.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, besoj do
3 të ishte koha e përshtatshme për të kaluar në seancë publike.

4 PY. Z. Dëshmitar, të lutem, ki parasysht që do jemi në seancë
5 publike, prandaj mos përmend as emrin tënd, as emra të tjerë
6 gjatë kohës që jemi në seancë të hapur.

7 PË: E kam të qartë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Dëshmitar, tani do të kalojmë në seancë të hapur, por nëse do
10 të thuhet diçka që mund të nxjerrë në pah identitetin tënd,
11 neve do ta heqim nga transkripti i shkruar. Në rregull?

12 DËSHMITARI: Në rregull.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
14 Sekretare, të lutem, të kalojmë në seancë publike.

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
18 faleminderit.

19 Z. Prokuror, vazhdoni.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

21 PY. Z. Dëshmitar, i the panelit, Trupit Gjykses, se arritët
22 në Zllash, a kishe qenë më parë në Zllash ndonjëherë?

23 PË: Jo.

24 PY. Nga e more vesh që ai vendi aty, në fakt, quhej Zllash?

25 PË: E mora vesh nga njerëzit që ishin mbrena për mbrena

1 PY. Ata dy njerëzit me maska, që të çuan te ahri, ata ishin
2 të veshur me uniformë?

3 PË: Po, me uniformë.

4 PY. Po të armatosur ishin?

5 PË: Nuk e di, s'kanë pasë armë, vetëm në qoftë se brezit i
6 kanë pasë. S'i kam pa armë.

7 PY. A të kujtohet nëse kishin ndonjë emblemë, ndonjë gjë,
8 shenjë në uniformat e tyre?

9 PË: Jo, kanë pasë, si zakonisht, të gjitha që kanë pasë
10 rrobat e UÇK-së, shenjën e flamurit. S'ka pasë diçka tjetër.

11 PY. Nga çasti që dole nga vetura deri sa të çuan ke ahri, a
12 vure re sesi qe ai vendi aty, a ku po shkoje, ishe në një
13 ndërtesë apo jashtë ndërtese? Vure re diçka?

14 PË: Jo, s'vura re se s'kisha kurrfarë parandjenje që ta
15 vëzhgoj shpinë apo diçka.

16 PY. Ti na the se të futën tek ky ahri. Hyrja, dera ishte nga
17 -- binte nga jashtë, futeshe nga jashtë brenda direkt?

18 PË: Po, nga jashtë, ishte poshtë. Ishte një shtëpi si duket
19 dy katëshe duhej të sillej nga ku oborri me ra poshtë edhe
20 poshtë asaj shtëpisë ishte një derë e vjetër. U hap dera dhe
21 unë hyna mbrenda.

22 PY. Sa i madh ishte ky ahri ku të futën?

23 PË: Ishte një hapësirë, s'ishte dhe i vogël po s'ishte edhe
24 shumë i madh. Aty ishte ku mbaheshin kafshët.

25 PY. Po dritare a kishte?

1 PË: Po, kishte një dritare të vogël.

2 PY. Po derë tjetër, përveç asaj që hyre brenda, kishte derë
3 tjetër?

4 PË: Jo, poshtë nuk ka pasë. Ishte dera dhe dritarja.

5 PY. Kur mbërrite aty, a kishte njeri tjetër aty brenda në
6 ahër dhe të kujtoj, të lutem, të mos përmendësh emra vetëm i
7 thuaj Trupit Gjykues nëse kishte apo jo njerëz të tjerë
8 brenda?

9 PË: Kur kam hy aty, kanë qenë edhe katër vetë të tjerë. I kam
10 gjetë aty.

11 PY. Pra, ky ahri, që ishin dhe këto katër vetat e tjera, a
12 ruhej me roje?

13 PË: Nuk e di. Nuk i kam pa. Nuk kam pa se ka pasë roje.

14 PY. Me sa të kujtohet, as brenda as jashtë derës nuk kishte
15 njeri që bënte roje?

16 PË: Jo, ata unë nuk i kam pa, po kur na kanë pru bukën ose
17 ujin mendoj që ajo ka qenë roja. Brenda dite dy herë na kanë
18 pru edhe ushqim edhe ujë. Ujë na kanë sjellë sa kemi dashtë
19 edhe ushqimi ka qenë i mjaftueshëm. Mendoj i mjaftueshëm për
20 kohët e luftës, çfarë ka qenë ajo ka qenë kohë lufte. Edhe e
21 them me bindje të vërtetë se qatë ushqim që e kanë hëngër ata
22 vetë, na e kanë pru të njëjtin edhe neve brenda aty.

23 PY. Si do të na i përshkruaje, më fal, përpara se të

24 përgjigjesh sa kohë ke ndenje në këtë ahër, z. Dëshmitar?

25 PË: Kam ndejtë prej katër dikund 18, 19 nuk më kujtohet dita

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 28
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 e saktë e daljes. Më duket se ka qenë 19 prill.

2 PY. A mund të na i përshkruash kushtet në këtë ahër që ke
3 ndenje dy javë, ku ke jetu dy javë? Si ishin këto kushte?

4 PË: Kushtet kanë qenë çnjerëzore. Kur individi edhe kur hyn
5 mbrena aty trajtohet -- nuk e ka më ndjenjën e njeriut po e ka
6 -- trajtohet me kafshën barazohet.

7 Unë nuk di si muj ta përshkruaj, kur njeri papritmas prej
8 një që se pret edhe gjendet në një ahër që s'e ka pa as ëndërr
9 ndonjëherë në jetë.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju lutem,
11 të kthehemi në seancë private për të qenë më të sigurtë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
13 Sekretare, ju lutem, na riktheni në seancë private.

14 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës
16 jemi në seancë private.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit znj. Sekretare.

19 Z. prokuror, keni fjalën.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

21 PY. Z. Dëshmitar edhe nja dy pyetje të tjera lidhur me
22 kushtet e ahurit. Ti dhe të tjerët që ishin aty, a flinit në
23 shtretër, krevat?

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Duket se Dëshmitari nuk merr
25 përkthim?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 29
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Dëshmitar, na dëgjoni? Z. Dëshmitar, dëgjoni? Një, dy, tre. Z.

3 Dëshmitar na dëgjoni?

4 DËSHMITARI: Po, po.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

6 Prokuror, ju sugjeroj ta përsërisni pyetjen. Të shohim nëse
7 funksionon përsëri.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Faleminderit. Ju kërkoj
9 ndjesë se pyetjen tjetër mund ta kishim bërë, në fakt, në
10 seancë publike, po do të duhet të kalojmë në private. Ju
11 kërkoj ndjesë.

12 PË: Z. Dëshmitar, ju, pra, ti dhe të tjerët, të cilët ju
13 mbajtën aty në ahur, flinit nëpër krevate?

14 PË: S'kishte aty punë krevati.

15 PY. Keni fjetur për dhe'?

16 PË: Në kushte çfarë kanë qenë na kanë pru kashtë, fati kanë
17 pasë kashtë të kafshëve jashtë dhe e kemi shtri kashtën. Mbi
18 kashtë ka pasë qebe, disa qebe, ka pasë [të] mjaftueshme edhe
19 me u shtri edhe me u mbulu me qebe. Kështu që kurrkush s'e ka
20 diskutu fjetjen ose kushtet çfarë ai, po ka qenë stresi dhe
21 ndjenja pse jemi aty. Unë, kërrkujt s'i ka ra në mend si po
22 flenë, mendoj.

23 PY. Po tualet brenda, banjë pra, brenda ahurit kishte?

24 PË: Jo mor s'kishte. Ishte një kafe na e sillnin edhe mbrena
25 24 orëve e qitshim jashtë, dikush prej nesh. Aty mbrena për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 30
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 mbrena i krynim nevojat fiziologjike.

2 PY. Më falni, kovën jashtë e nxirrni ju apo e merrni rojet
3 dhe për ta zbrazi?

4 PË: Një prej rojeve vinin dhe ne u deshke ta kapim një vetë
5 ose dy vetë, i venim maska në fytyrë, domethënë ata që e
6 kapshin kovën ishin me maskë, i venim maska edhe i dërgonin
7 pak ma larg ku duhej të derdhej ajo edhe i sillnin prapë me
8 maskë mbrena.

9 PY. Ti ose të tjerët, a mund të kishit dalë nga ahuri gjatë
10 atyre [REDAKTUAR], po të kishit dashur të dilnit?

11 PË: Të tjerët nuk e di, unë kam pasë mundësi sepse i
12 falënderoj edhe [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR] -- kam

17 pasë mundësi me ik, po s'kam pasë arsye të iku. Ja u di për
18 nder, [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

23 PY. Po befasohem pak se gjatë intervistës me Prokurorinë
24 Speciale, na u krijua përshtypja se nuk kishit mundësi që të
25 dilnit nga ahuri.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 31
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mbase mund
2 t'ia rifreskojmë kujtesën dëshmitarit me një pjesë të
3 deklaratës që i ka dhënë ZPS-së?

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
5 po, përndryshe do ta kishim kërkuar ne këtë sqarim.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Është me numrin ERN 061016-
7 TR-ET, Pjesa 1, faqja 24, ju lutem.

8 PY. Z. Dëshmitar, ky është teksti i zbardhur i intervistës
9 tuaj me ZPS-në, të intervistës tënde me ZPS-në, është në
10 anglisht por ndërkohë që lexoj unë do ta përkthejë përkthyesi.

11 Këtu po i tregoje prokurorit se pas një jave të çuan
12 lart. Edhe prokurori të pyeti:

13 "Ishte hera e parë kjo që dole nga ahuri, nga ajo dhoma
14 ku po qëndroje?"

15 Dhe përgjigja jote ishte:

16 "Po, pas një jave nuk kishim mundësi me dal nga ai ahur
17 për me marrë ajër apo diçka nuk kishim mundësi, nuk kishte
18 shans".

19 Nuk e di a të rikujtohet tani lidhur me këtë?

20 PË: A ka mundësi Z. Prokuror, me ba një sqarim. Ju më pyetët
21 se a ka ekzistuar mundësia me ik në Zllash? Unë e them me
22 përgjegjësinë më të madhe brenda në dhomë sa kam qenë nuk ka
23 pasë shans me ik as unë as kushdo qoftë. Unë nuk e thashë pse
24 mbrena kemi pasë mundësi mbrena dhome, po një herë ose dy unë
25 kam pasë rastin më kanë çu në tualet. Unë prokurorit s'i kam

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 32
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 thënë -- më ka thënë kur më ka pyet në Prishtinë se më ka
2 pyetë, a keni pasë mundësi me ik nga -- unë për ikjen e kam të
3 qartë.

4 A është e vërtetë që prej dhome një herë më kanë nxjerrë,
5 kur më kanë çu mbas një jave naltë që jam deklaru. Edhe ajo
6 nxjerrje që ka qenë ka qenë natën nuk kam pa asgjë. Po mendoj
7 kur më kanë çu për tualet, ka qenë natën, ka qenë. Mirëpo s'më
8 kanë vu as maskë, kam qenë i lirë, as mi kanë lidhë duart, kam
9 mujtë me ik po s'kam pasë arsye me ik.

10 A është e vërtetë që hera e parë mbrena, sa kam ndejtë
11 prej [REDAKTUAR] deri më 19, hera e parë që më kanë marrë edhe
12 më kanë çu lartë është vetëm njëherë. Për këtë jam deklaruar
13 edhe në Prokurori në Prishtinë. Hera e parë që kam dalë prej
14 atij ahri ditën.

15 PY. Faleminderit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
17 dua t'jua ndërpres pyetjet por dua që të sqarohem unë, që të
18 mos ta bëjë nesër meqenëse jemi tani.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Patjetër, e nderuar Gjykatëse.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
21 Dëshmitar, siç, që ta kuptoj unë, më falni që ta kuptojë unë.
22 Nga ahuri, a mund të dilje dhe të ktheheshe në shtëpi kur të
23 doje?

24 DËSHMITARI: Jo s'kishte shans. S'ekzistonte ajo mundësi
25 kurrfarë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 33
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

- 1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
- 2 Atëherë është e qartë për mua.
- 3 Z. Prokuror, keni fjalën.
- 4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit që e sqaruat, e
- 5 nderuar Gjykatëse.
- 6 PY. Z. Dëshmitar, jemi ende në seancë private. Gjatë kohës që
- 7 kalove në ahur, që ishe në ahur, a kishe mundësi me bisedu me
- 8 të tjerët, me katër personat e tjerë që the se ishin aty në
- 9 momentin që shkove në ahur.
- 10 PË: Po si, kishim kohë në të bisedonim mjaft.
- 11 PY. Na the se ishin katër persona aty në ahur kur mbërrite
- 12 ti. A sollën ndonjë tjetër pas mbërritjes tënde?
- 13 PË: Pas nja shtatë-tetë ditë kanë sjellë edhe një.
- 14 PY. Tani, dëshiroj të të kërkojë ndihmë për të përmendur se
- 15 kush ishin personat me të cilët ke qëndruar aty brenda. Edhe
- 16 njëherë të rikujtoj se jemi në seancë private, pra, nuk ka
- 17 problem nëse përmend emra.
- 18 Pra, a të kujtohet, ishin pesë persona të tjerë të cilët
- 19 ishin me ty aty në ahur. Cilët ishin këta?
- 20 PË: Vetëm dy emra më kujtohen, të tjerë nuk më kujtohen.
- 21 PY. S'ka problem, në rregull. Mund ta fillojmë me këta dy
- 22 emra që të kujtohen?
- 23 PË: Po, ishte një [REDAKTUAR] edhe një [REDAKTUAR].
- 24 PY. Të kujtohet [REDAKTUAR]?
- 25 PË: Jo, s'më kujtohet se s'kam hi me e mbiemrave, s'kemi qenë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 34
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 në gjendje me pyet për mbiemrat kështu s'na kanë interesu.

2 Vetëm si emra i kam ditë.

3 PY. Po nga ishte, të kujtohet?

4 PË: Nuk di për nder. S'di.

5 PY. The se tjetri e kishte emrin [REDAKTUAR]. Të kujtohet

6 [REDAKTUAR] nga ishte?

7 PË: Jo, jo hiç s'kishim njohuri për asnjënin s'di a të kujt

8 janë. Ndoshta edhe ata për mu s'kanë ditë ka jam. S'kemi hi me

9 i spjegu kërrkujt ka je. Bisedën krejt e kemi bë qysh, pse

10 jemi këtu edhe qysh ka -- a ka mundësi me dalë ndonjëherë prej

11 aty.

12 PY. E kuptoj, z. Dëshmitar, se ka kaluar shumë kohë, por, në

13 fakt, gjatë intervistës ti pate mundësi ti japësh diçka më

14 shumë informacion ZPS-së, Zyrës së Prokurorit të Specializuar

15 dhe, të nderuar Gjykatës, me lejen tuaj nëse mund të shfaqim

16 në ekran dokumentin me numër ERN 061016-TR-ET Pjesa 1, faqja

17 20.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për

19 procesverbalin, pohova me kokë, z. Prokuror, kur e bëtë këtë

20 pyetje.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe faqja, në fakt, është 21,

22 të nderuar Gjykatës.

23 Tani nëse kalojmë tek rreshti 17 deri në 21 në ekran.

24 PY. Kur të ka pyetur prokurori, se kush ishin këta personat

25 me të cilët ke qenë aty brenda the që "ka kaluar shumë kohë po

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 35
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 ishte një [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR].

3 T'u rifreskuat kujtesa, të paktën për një prej këtyre
4 bashkëtëndaluarve aty?

5 PË: Kjo e vërtetë. Por dhe sot s'jam i bindur se ka qenë
6 [REDAKTUAR] a jo. A kujtesa pse është quajt [REDAKTUAR],
7 më kujtohet. Ndoshta ka qenë. Unë e kam thënë, unë e kam pasë
8 bindjen që ai person është [REDAKTUAR] se vetë fakti që më ka
9 thënë jemi në Zllash, e kam ditë që është i afërt aty po e din
10 rajonin ku jemi. Personalisht s'më ka thënë ai vetë që është
11 [REDAKTUAR].

12 PY. E kuptoj qartë që ishte, pra, që e more vesh që po ju
13 mbanin në Zllash nga [REDAKTUAR]?

14 PË: Po. Pikërisht nga ai.

15 PY. Faleminderit. E kuptoj se mbase mund të jetë e vështirë
16 që të rikujtohen disa hollësi, prandaj dhe i kërkoj leje
17 Trupit Gjykues herë pas here për të parë dëshminë e
18 intervistës.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Tek e njëjta intervistë, nëse
20 kalojmë në faqen 22 në rreshtat 6 deri në rreshtin 8, pra, 6
21 deri në 8.

22 PY. Pyetja që të kanë bërë aty është nëse të kujtohet ndonjë
23 tjetër që ishte në ahur, ke thënë që ishte një farë
24 [REDAKTUAR] Të kujtohet, z. Dëshmitar?

25 PË: Ndoshta e kam thënë, po e di që e quanin [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 36
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 PY. Kjo [REDAKTUAR]
2 PË: [REDAKTUAR] më se -- nuk di a ka qenë java mes atyne
3 ditëve sa kam qëndru aty, njëherë kanë hi dy vetë të maskum
4 edhe [REDAKTUAR] i kanë thënë "Çka po afroresh ti nga të
5 [REDAKTUAR]?" Mu mu kanë drejtu "[REDAKTUAR], ky është
6 [REDAKTUAR]". Fjala ishte për [REDAKTUAR], në qoftë se ka qenë
7 ai me mbiemër [REDAKTUAR]. Edhe për [REDAKTUAR] më kanë thënë
8 "Ky është [REDAKTUAR]". Më shumë unë bile për
9 [REDAKTUAR] nuk më ka lënë përshtypje të [REDAKTUAR] sepse
10 ishte një njeri i varfër dhe kam thënë unë në qoftë se ka pre
11 një kerr dru edhe i ka dhënë një [e pakuptueshme] shumarit,
12 s'do të thotë që është [REDAKTUAR] ose bashkëpunëtor i
13 Serbisë. S'më ka lënë përshtypje ai njeri që mund të jetë, se
14 [REDAKTUAR] kishte [REDAKTUAR] Kjo ka qenë, kur e
15 kam marrë vesh që ai quhej [REDAKTUAR]
16 Edhe të gjithë ata edhe ky që e kanë sjellë bukën edhe
17 ata dy që kanë hi, ja u di për nder se më kanë shiku me
18 simpati. Nuk janë fajtor at që kanë qenë mbrena për burgut as
19 nuk e fajësoj askënd aty. Pasi që edhe në Kryeprokurori, kam
20 thënë, personat që s'i kam njoftë, s'e kam njoftë askënd nuk i
21 akuzoj. S'kam ardh me i mbrojt po nuk dua të akuzoj kërrkënd
22 pa faj. Ata janë sjellë në mënyrën më -- flas prej asaj date
23 që kam qenë, z. prokuror, deklarohe botënisht para Gjykatës,
24 prej datës [REDAKTUAR] 19 prill, deklarohe me përgjegjësinë
25 më të madhe shpirtnore e njerëzore, asnjë njeri nuk është
nxjerrë as gjatë ditës as brenda mbrëmjes nga ajo dhomë,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 37
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 përpos unë jam nxjerrë njëherë kam shku lart. Unë flas për
2 gjatë -- çka ka ndodhë përpara nuk jap llogari. Kjo është më
3 se e vërteta edhe e them me bindje një milion për qind të
4 vërtetë dhe jap llogari para Prokurorisë edhe Gjyqtares në
5 qoftë se nuk është e vërtetë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
7 prokuror, më lejoni.

8 Z. Dëshmitar, dëshiroj t'ju kujtoj se kur ta bëj një
9 pyetje, t'i përgjigjesh pyetjes. Nëse nuk e di mund të thuash
10 "Nuk e di".

11 Përpara këtyre që na thatë për [REDAKTUAR] ishte vetëm,
12 atë kujtohet që i ke thënë prokurorit në Prishtinë se
13 [REDAKTUAR] ishte nga [REDAKTUAR]?

14 Për procesverbalin e përmend që është në faqen 23,
15 rreshti 5.

16 Po ta përsëris unë këtë pyetje: A të kujtohet që i ke
17 thënë prokurorit - se ka qenë një prokuror në Prishtinë - që i
18 ke thënë prokurorit që [REDAKTUAR] ka qenë nga [REDAKTUAR]?
19 Kjo është pyetja. Dhe vetëm kësaj t'i përgjigjesh.

20 DËSHMITARI: Po më kujtohet. Është po, i kam thënë edhe
21 se kohë pas kohe po i harroj edhe atë e kam marrë vesh prej
22 tjerëve që [REDAKTUAR] është pi [REDAKTUAR], kur kemi dalë nga
23 burgu. Atë ditë kur kemi dalë, më 19 prill e kam marrë vesh se
24 ai person është [REDAKTUAR].

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 38
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 z. Dëshmitar, më kupton ç' dua të them që ndonjëherë e shikoj
2 që i bini rrotull e rrotull në vend që t'i jepni një përgjigje
3 pyetjes.

4 DËSHMITARI: Jo, pse i bie rrotull, po ka kaluar një kohë
5 shumë e gjatë. Edhe nga Prokuroria është më se një vit e diçka
6 që i kam dhënë intervistën.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
8 Prokuror, mund të vazhdoni.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara
10 Gjykatëse.

11 PY. Z. dëshmitar, diçka që sapo thatë, për këtë dua të të
12 kërkoj që të sqarosh se për çfarë e kishe fjalën, se duket
13 sikur bie ndesh me atë që i ke thënë Prokurorisë gjatë
14 intervistës.

15 The, pikërisht tani, nuk ka shumë, pak minuta më parë,
16 the se mund, pra, mund të thuash që askush, askënd nuk kishin
17 marrë nga ahuri gjatë natës apo gjatë ditës me përjashtim të
18 atij rastit kur të morën vetëm ty e të çuan jashtë.

19 Këtë sapo e thatë, por...

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës.

21 DËSHMITARI: Po, është e vërtetë që e kam thënë.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, ju lutem, me 061016-TR-ET,
23 Pjesa 3, faqja 10, të nxjerrë në ekran rreshtat 1 deri në 13.

24 PY. Z. Dëshmitar, këtu po flisje për një të burgosur që
25 mbërriti në ahur mbas mbërritjes tënde. Të kujtohet emri a

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 39

Pyetje nga Z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 nofka si e thërrisnin këtë personin që mbërriti pas teje?

2 PË: Më duket, më duket se aty për aty e kanë thirr e kam

3 dëgju [REDAKTUAR] t'u e thirrë.

4 PY. Po. Të pyetën --

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jam, të nderuar Gjykatës, te

6 rreshti 1 i faqes 10.

7 PY. Për atë javën që mbërriti ky i riu, a ke fol me të? Dhe

8 ti u përgjigje:

9 "Jo, se ka qenë keq, i rrehur shumë keq, i maltrajtum".

10 Pastaj të bënë pyetjen:

11 "Kur kishte ndodhur kjo?"

12 Dhe ti the:

13 "Që atë natë që ka ardhë. E kanë sjellë në mes të natës".

14 Prokurori vazhdoi:

15 "Po kur e kishin rrahur?"

16 Dhe ti the:

17 "Atë natë, që atë natë. Që atë natë e kanë rrahë. Nuk

18 mund merrnin më, pra, ai mezi çohëj, mezi rrinte në këmbë

19 s'kish nevojë më."

20 Pastaj të pyeti prokurori:

21 "Po ku e kishin rrahur?"

22 Dhe ti u përgjigje -- është në rreshtin 17 këtu:

23 "Rrahja më e fortë, më e madhe është që ku i merrnin. Po

24 se ku as ata s'e dinin".

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 40
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 falni. Ju kërkoj që prova që është në ekran të zhvendoset
2 paksa se nuk e shohim.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më falni.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
5 nuk e kisha me ju. E kisha me Sekretaren. Faleminderit.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Pra, pjesa e fundit që lexove
7 është rreshti 17 deri në 19.

8 PY. Pastaj prokurori të tha:

9 "Po, po ku e kishin rrahur këtë të riun?"

10 Dhe ti u përgjigje:

11 "Krejt trupin"

12 Kjo mjafton tani për tani.

13 Z. Dëshmitar, të rikujtohet tani lidhur me faktin që i
14 merrnin njerëzit, i nxirrnin nga ahuri gjatë qëndrimit tënd
15 aty.

16 PË: E deklaroj botënisht se nuk e kam thënë asnjëherë as në
17 Prishtinë, as këtu se i nxjerrin nga ahuri njerëzit. Jam i
18 vetëdijsëm. Po jam deklaruar që s'kanë nxjerrë asnjëherë gjatë
19 qëndrimit tim nuk e kanë nxjerrë asnjë person sa kam qëndru
20 gjatë asaj kohe. Kjo është deklarata edhe në Prishtinë. Në
21 qoftë se është keqkuptu është diçka tjetër. Po kem thanë se e
22 kanë nxjerrë dikën nuk është kjo. Do ta thoja dhe sot, por dhe
23 atëherë e kam thënë, se s'e kanë nxjerrë asnjë person gjatë
24 qëndrimit tim, të kohës sa kam qëndru aty, nuk është nxjerrë
25 as nuk është maltratu, as natën as ditën, as unë as të tjerët.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 41
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Prokuror, thjesht, për t'ju informuar se po i afrohem orës
3 11:00.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

5 PY. Z. Dëshmitar, është dëshmia jote sot që nuk ja ke thënë
6 këtë prokurorit kur të ka marrë në intervistë asokohe? E
7 kuptoj saktë?

8 PË: Z. Prokuror, me siguri nuk e fajësoj as prokurorin, mund
9 të jetë keqkuptu. Edhe atëherë me bindje të thellë e them edhe
10 sot e them, asnjëherë nuk kam përmend se është nxjerrë ndonjë
11 person nga dhoma. Unë do ta thoja dhe sot botënisht. Unë, z.
12 Gjykatëse dhe z. Prokuror, nuk kam ardhë këtu as ta mbroj
13 dikënd por nuk dua të akuzoj as dikën pa faj. Kjo është
14 deklarata me vetëdije të plotë nuk është nxjerrë asnjë person,
15 sa kam qëndru unë, as ditën as natën nga dhoma për t'u
16 maltratu.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mbase -- a më falni.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Von Bone, vura re që u ngritët në këmbë pastaj u ulët.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse, sepse
21 mendoj nëse ne shkojmë në faqen 11 të traskriptit...

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
23 Dëshmitar, mund t'i hiqni dëgjueset, ju lutem.

24 Z. Von Bone, keni fjalën.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk jam i sigurt se ka çfarë ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 42
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 ndërmend z. Prokuror, por ne besojmë se kjo është në përputhje
2 me atë që ka thënë zotëria në faqen 11.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
4 Von Bone, nuk ju dëgjoj mjaftë mirë. Nëse mund të flisni më
5 afër mikrofonit sepse nuk ju kuptoj shumë mirë.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Pyetja që po bën Prokurori është
7 nëse i ka deklaruar diçka tjetër prokurorit në Prishtinë në
8 dallim nga ajo që deklaroi këtu. Por nëse lexojmë pak më tutje
9 në të njëjtin tekst dhe unë, ne besojmë se kjo përputhet me
10 atë që, në fakt, ka thënë dëshmitari.

11 Mbase, mbase, mund ta zgjerojmë paksa ose mbase nuk e
12 keni parë ju po unë nuk mendoj se zotëria këtu po deklaroi
13 diçka tjetër nga ajo apo se po deklaroi diçka që nuk e ka
14 deklaruar në Prishtinë. Sepse unë vërtetë besoj që është në
15 përputhje me atë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
17 Von Bone, mendoj se dëshmitari e ka bërë shumë të qartë se
18 çfarë ka dashur të thotë për të. Nëse ju doni të shtoni
19 diçka në pyetjet që ju do ia bëni dëshmitarit, mund ta bëni.
20 Hë për hë, doja të z. Prokuror që të vazhdojë megjithëse në
21 fakt jemi në orarin e pushimit, mbas pushimit sigurisht.

22 Z. Prokuror.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, patjetër që mund ta bëjmë
24 pushimin tani dhe mund t'i rikthem pas pushimit kësaj pike.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 43
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 dëshmitar, mund t'i vini ndëgjueset.

2 Znj. Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë publike.

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
5 jemi në seancë publike.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit, znj. Sekretare.

8 Z. Dëshmitar, ka ardhur koha për pauzën e parë, kështu
9 që, asistentja e sallës do të shoqëroj për të dalë nga salla
10 dhe do të shihemi pas gjysëm ore në orën 11:35 minuta.

11 DËSHMITARI: E kuptoj.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
13 rregull, do t'ju shoqëroj asistentja e sallës. Mund t'i hiqni
14 dëgjueset dhe mund të dilni nga salla.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] z.
17 prokuror, shoh që jeni akoma në këmbë.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më falni, në fakt, duhet të
19 isha ulur.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
21 rregull. Do të rishihemi në orën 11.35 minuta, pra, 30 minuta
22 prej tani.

23 E mbyllim këtu për tani, për tu riparë pastaj.

24 --- Seanca përfundon në orën 11.05 paradite

25 --- Seanca rifillon në orën 11.35 paradite

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 44
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
2 rregull, nuk shoh të ketë ndodhur ndonjë ndryshim në përbërjen
3 e ekipeve kështu që mund të vazhdojmë.

4 Sekretarja, të lutem, sille dëshmitarin brenda.

5 Faleminderit për dritën që ndezët.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
8 se je kthyer zoti Dëshmitar.

9 DËSHMITARI: Mirë se ju gjej.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
11 Prokuror, keni fjalën për të vazhduar me pyetjet e
12 dëshmitarit.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
14 Gjykatëse.

15 Py. Zoti Dëshmitar, po flisnim për ditën por në fakt, të
16 nderuar Gjykatës, duhet të kalojmë në seancë private.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Seancë private.

19 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Vazhdoni, zoti Prokuror.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

24 Py. Zoti Dëshmitar, përpara pushimit unë po të pyesja për
25 kohën kur ky personi që ti the quhej -- e kishte [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 45
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [REDAKTUAR], për kohën kur e kanë sjellë atë në ahër. A e mban
2 mend se i ke thënë prokurorit se kur e kanë sjellë [REDAKTUAR]
3 aty ishte i rrahur.

4 Pë. Është e vërtetë se ai është paraqit që ka qenë i rrahun,
5 unë nuk -- dhe e kanë pru diku kah mesi i natës.

6 Py. A të kujtohet që i ke thënë prokurorit se ishte rrahur
7 keq, ishte maltrajtu?

8 Pë. Po, është e vërtetë, se e kom thonë se ai para - smun as
9 të çohet, kështu ipte zor, mezi çohet në këmbë.

10 Py. Kur ti shkove ke ky hauri, a të tha ndonjë prej atyre që
11 ishin aty se i kishin rrahur?

12 Pë. Jo, asnjëri prej tyre.

13 Py. Ti po thua që asnjë prej personave të tjerë nuk e ka
14 përmendur që i kanë rrahur? I kërkoj ndjesë Trupit Gjykues që
15 po e bëj këtë pyetje por dua të sigurohem që këto që thotë
16 tani janë si ato që ka thënë atëherë kur e ka dhënë dëshmi
17 Prokurorit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Vazhdoni.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

21 Py. Pra, je i sigurt që asnjëri nuk të tha që i kishin rrahun
22 në një moment të caktuar?

23 Pë. Unë e kom kuptu vetë se gjatë dy-tre ditëve nuk kanë pas
24 shenja as në fytyrë, as në duar, as në kokë, kanë pasur shenja
25 të -- i kom vërejt, e kanë pas shpinën të skuqur. Dhe aty e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 46
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kam kuptu që kanë mujt me qenë pej të rrahunat ato -- se
2 kurrfarë gjurme ata kanë lëviz lirisht, kanë kcy, janë ndesh -
3 - kanë bo fizkulturë. Domethënë, asnjëri s'ka pas ndonjë
4 gjymtyrë të thyme apo diçka tjetër, as shenja në kokë, as në
5 fytyrë s'ja kom pa. Shpinën -- jam deklarue edhe atje, në
6 Prishtinë, dy-tre vetëve ju kam pa shpinën të skuqur. Edhe në
7 shpinë nuk kanë pasur shenja, vetëm e kanë pasur të skuqur.

8 Ndoshta nuk kanë hi me m'spjegu se çka ka ndodh me ta, ju
9 garantoj asnjëri s'më ka thënë që është maltrajtu prej dikujt
10 tjetër.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
12 më shfaqni në ekran provën materiale 061016-TR-ET, Pjesa 3,
13 faqja 7?

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
15 Sekretare, vazhdoni me paraqitjen e këtij dokumenti.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do të lexoj nga rreshti 5 deri
17 në rreshtin 13, të nderuar Gjykatës.

18 Py. Pra, zoti Dëshmitar, Prokurori atëherë të ka pyetur:

19 "Py. Çfarë të kanë thënë këta të tjerët se ju ka
20 ndodhur?"

21 Ti the: "Ata që kanë qenë përpara meje nuk e di para se
22 sa kohësh përpara se të shkoja unë aty."

23 Pastaj Prokurori të ka pyetur:

24 "Çfarë të kanë thënë se u ka ndodhur kur i kanë nxjerrë
25 prej stallës, apo haurit dhe i kanë çuar lartë?"

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 47
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Dhe ti the -- je përgjigjur:

2 "I kanë rrahur keq. I kanë rrahur kaq keq sa ata thanë
3 ndiheshin sikur i kishin rrahur si kafshë. Pra kaq të forta
4 ishin këto të rrahurat, sa më mirë të kishin vdekur", të kanë
5 thënë ata.

6 Dhe Prokurori pastaj ka vazhduar në rreshtin 125 deri në
7 17:

8 "Dhe kush të kanë thënë se i kanë rrahur?"

9 Ti ke thënë: "I morën natën dhe se kishin maska personat
10 që i morën".

11 Tani, zoti Dëshmitar, siç e shikon nga këto që të lexova,
12 ato që i ke thënë atëherë prokurorit janë të ndryshme nga këto
13 që po na thua sot përpara Trupit Gjykses. Tani që ta lexova
14 këtë pjesë të intervistës, a të kujtohen që i ke thënë këto
15 fjalë?

16 Pë. Tani, sqarim, Zonja Gjykatëse, edhe zoti Prokuror: unë
17 jam shumë i vetëdijshëm çka kom thënë. Është e vërtetë, edhe
18 dua -- intervistën që e kom shanë në Prishtinë është
19 filmikisht. Në qoftë se diku ekziston që e kom thënë "e kanë
20 nxjerrë dikën sa kam qenë unë nga ai haur dhe e kanë
21 maltrajtu, lirisht unë paraqitem si i akuzuar, jo si
22 dëshmitar.

23 S'është e vërtetë që e kanë nxjerrë askënd, s'e kam thënë
24 as në Prishtinë. Për rrahje, është bisedu. Unë s'kam pas
25 lidhje ça ka ndodh, ata me i pas ndigju unë, me i pas ndigju

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 48
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 une isha çmend. Unë nuk i kom besu, kur deri sa as që kam pas
2 gjurmë në trupin e tyre, nuk kam pas ide se janë maltrajtue
3 deri në atë shkallë. Po nxjerrë nga dhoma, nuk është nxjerrë
4 askush.

5 Nuk -- është filmikisht -- kërkoj që të shikohet kamera,
6 që e kam dhënë intervistën. Edhe tash po deklaroj edhe një
7 herë. Asnjë person, sa kom qenë unë, çka ka ndodh para meje
8 nuk di. Pej [REDAKTUAR] 19 prill nuk është nxjerrë nga ajo
9 dhomë që të maltrajtohet. As nuk kam thonë që i kanë nxjerrë
10 prej dhome, i kanë çu me i maltrajtu. Ata nëse kanë qenë të
11 maltrajtum, kanë qenë para se të shkoj unë aty. Kështu e kam
12 thonë edhe në Prokurori në Prishtinë.

13 Edhe një herë e deklaroj publikisht, të gjithë personat
14 që kanë qenë me mua në dhomë, asnjë nuk ka pasur lëndime në
15 fytyrë, nuk ka pas lëndime në kokë, nuk ka pas lëndime në
16 këmbë, nuk ka pas lëndime në gjunjë, përpos që shpinën e kam
17 parë pak të skuqur. Me përjashtim të këtij që ka ardh ma vonë
18 në dhomë, ka thanë se ka qenë i rrahur keq. Po edhe atij
19 shenja s'i kam pa në trup. Unë flas me fjalët e tij, çka ka
20 thanë. Kaq kisha.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
22 Dëshmitar, ka dy gjëra. E para: se pyetja që po të bëhet është
23 nëse ata njerëzit që ishin aty që ishin përpara teje, pyetja
24 është a ishin rrahur ata? Si do të përgjigjeshe për këtë
25 pyetje?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 49
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 DËSHMITARI: Sipas tyre, po.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
3 rregull, pra është e qartë. Përpara se ti të veje aty, ishin
4 rrahur. Më le të mbaroj një herë unë pastaj, se ndryshe është
5 vështirë që të përkthehet.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Kam kundërshtim.

7 Ai nuk tha se ishin rrahur, që nënkupton pyetja juaj. Ai
8 tha "kështu më thanë". Kaq tha.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
10 atë tha dhe është regjistruar.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Pra nëse pyetja juaj është që "a
12 ishin rrahur" unë besoj që nuk është e saktë sepse ai tha që
13 më kanë thënë që ishin rrahur.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pika
15 e dytë që kam: zoti Dëshmitar. Zoti Prokuror, më lejoni që të
16 pyes Dëshmitarin për diçka për ta lidhur me atë që thatë, për
17 ta sqaruar me këtë që po thotë tani.

18 Në deklaratën që ke dhënë si dëshmitar për procesverbal,
19 pjesa 1, faqja 26, rreshti 13 dhe 14, ke thënë:

20 "Të gjithë -- i ke thënë Prokurorit atëherë në
21 Prishtinë".

22 "Të gjithë kishin shenja në trup dhe kishin edhe vrima".

23 A të kujtohet që i ke thënë këto fjalë Prokurorit?

24 DËSHMITARI: Nuk i kam thonë. Me përjashtim të tre vetëve,
25 nuk i kam thënë "të gjithë". Edhe atje e kom cekë "dy-tre

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 50
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 vetë". Se jom i singertë, edhe sot unë e di ça kam thënë.

2 Ndoshta përkthimi, a si është marrë vesh Prokurori nuk e di.

3 Janë incizimet. Nuk kom thënë që kanë qenë të gjithë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse
5 të kuptova mirë tani, the dy apo tre prej tyre. Këtë po thua?

6 DËSHMITARI: Po. Këtë e kam thënë. Edhe sot po e them.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa
8 persona ishin në haur, përveç teje, ty s'po të llogarisim.

9 DËSHMITARI: Pesë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
11 rregull. Këto ishin pyetjet që kisha për momentin, tani ja jap
12 fjalën përsëri Prokurorit.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

14 Py. Zoti Dëshmitar, Kryetarja të pyeti nëse ti e mësove nga
15 të tjerë që ishin rrahur dhe ti e pohove. Por the -- ke thënë
16 që ishin rrahur kaq keq, të kishin thënë ata, sa kishin thënë
17 "më mirë të kishim vdekë". Sepse siç the, ne e kemi
18 intervistën të incizuar në video, deh mund ta tregojmë në
19 qoftë se kjo ta kujton, ta freskon kujtesën lidhur me këtë
20 dëshmi që ke dhënë.

21 Pë. Po, është e vërtetë se ata më kanë thënë. Po unë s'e kam
22 besuar fare se s'kam parë shenja në trupin e tyre. Unë nuk du
23 me hi sa çka m'kanë thanë ata. Unë as nuk i kom pa kur i kanë
24 rrah dikush, as nuk jam përgjegjës për atë punë. Por sipas
25 vlerësimit tim -- se unë kom përvojë edhe me burgje të tjera,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 51
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 ne nga një javë s'kemi mujt me lëviz kur kemi pas rrahje. Te
2 ata nuk kam vërejt shenja, po e them edhe një herë. As në
3 fytyrë, as në kokë, as në duar, as në këmbë. E kam thënë edhe
4 në Prishtinë, dy tre vetë më kan thanë që kemi qenë të rrahur
5 shumë keq, po unë te ta kam vërejtur -- as që kom vërejt kur
6 janë zhveshur, kanë pas ende shenja të skuqura në shpinë, në
7 dorë dhe në këmbë nuk kanë pas.

8 Këtë e kam thonë edhe në Prishtinë, po e them edhe sot.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
10 Dëshmitar, atë që ke thënë në deklaratën që ke dhënë më herët
11 kur të ka intervistuar Prokurori, është ajo që të lexova.
12 "Kishin shenja në trup, dhe kishin edhe vrima, ke thënë, në
13 trup".

14 DËSHMITARI: [E pakuptushme].

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një
16 minutë të flas unë pastaj ti. Do të kesh shumë rast të thuash
17 atë që do të thuash prandaj ke ardhur këtu.

18 Këto janë thënë këtu, dhe këto janë regjistruar atëherë.
19 Tani mund ta sqarosh se ç'ke dashur të thuash, por ajo që
20 është shkruar në parim është thënë. Por, nëse është e
21 nevojshme, siç tha edhe zoti Prokuror, mund të ta shfaqim edhe
22 një herë intervistën. Por ti ke ardhur këtu të sqarosh këto që
23 ke thënë në atë kohë.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

25 Py. Zoti Dëshmitar, pra është e qartë këto që u thanë lidhur

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 52
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 me të rrahurat. Unë e kam fjalën për rreshtat 22 deri në 23 që
2 është tani në ekran, që ta përsërisim për procesverbalin,
3 është 06016-TR-ET Pjesa 3. Ti ke thënë:

4 "Për sa i takon të rrahurave, po, më thanë".

5 Pastaj vazhdon:

6 "Ata s'kishin nevojë të më thoshin, të më tregonin se ua
7 pashë edhe vetë trupat". Pra, zoti Dëshmitar, mua më duket se
8 ka pasur ca shenja që ti i ke parë, që tregonin se në fakt të
9 rrahurat kishin ndodhur. Përveç atyre që të thanë me fjalë,
10 apo jo?

11 Pë. Zoti Prokuror, unë sot po e dëgjoj, nuk di si vrima --
12 sot po e mësoj nga ju. Unë e kam thënë, kanë pasur shenja në
13 trup, ka pas ndoshta edhe vija, të shenjave. Vrima nuk kam
14 thënë.

15 Py. Jo, jo, jo. Në fal, zoti Dëshmitar. Unë nuk thashë
16 "vrima" tani. Por ti ke thënë atëherë që pe shenja, shenja.
17 "S'kishin nevojë me m'tregu ato mua që i kishin rrahur". Jo
18 vrima. Por këto shenja që kishin në trup, këto vijat që ke
19 parë, a nuk tregonin që ishin rrahur? Kështu thotë
20 transkriptimi.

21 Pë. Është e vërtetë. E kam thonë edhe e kam bindjen e plotë
22 edhe sot që kanë qenë tash, po jo të rrahura që s'mund të
23 çohen në këmbë, ose diçka tjetër. Sipas mendimit tim. Kanë pas
24 shenja në trup, edhe një herë e kam thënë, dy tre vetëve ja
25 kam parë shpinat të skuqur dhe kanë pasur -- e kam përshkruar,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 53
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 vija të skuqura, vrima nuk kam thënë.

2 Py. A kishit frikë gjatë kohës që keni qëndruar në këtë haur?

3 A keni ndjerë frikë?

4 Pë. Unë po deklaroja edhe tash -- edhe në Prokurori, ajo ka
5 qenë çmenduri i atij personi që më ka fut aty. Unë e kam
6 ndjerë veten një lloj kafshe. Nuk kam qenë më qenie njerëzore
7 brendapërbrenda. Nuk di si e kam vlerësu edhe veten, në qoftë
8 se, për një moment jam gjendur në një haur të kafshëve. Ai
9 është nënçmimi më i madh në jetën që mu ka bo nga ndonjë e
10 ndjen vetë që nuk kanë qenë individë të tjerë, por aty është
11 një person -- s'mund të jetë përfshirë të gjithë personat.

12 Py. Gjatë qëndrimit aty në haur, ke pasur frikë se mos ndodh
13 diçka për jetën tënde?

14 Pë. Posi s'kam pasur. Unë s'kam ditë çka -- çka më zen
15 mbrëmja ose mëngjesi. Pa kurrfarë sqarimi.

16 Py. Ta bëra këtë pyetje se më herët dhe do jap vendin ku e
17 ke thënë mbas pak, ti the se ishe në një farë mënyre
18 mirënjohës njerëzve që të mbajtën aty, sepse të trajtuam mirë.
19 Pra, ke qenë mirënjohës ndaj atyre njerëzve që të kanë
20 trajtuar mirë gjatë qëndrimit tënd në haur?

21 Pë. Asht e vërtetë se ata nuk janë fajtorë pse kam qenë unë
22 aty. E kam bindjen e plotë. Ju më pyetët si e kam ndi veten
23 unë aty. Unë e thashë nuk e kam ditë e m'zen mëngjesi a
24 mramja. Kurse për personelit aty, që kanë qenë, që na kanë
25 sjellë bukën, dhe na e kanë dhënë mundësinë me shku në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 54
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 toilette me i çu kantën, jam shumë mirënjohës. Ata [REDAKTUAR]
2 [REDAKTUAR], më kanë sjellë. Po mos të kishin ndonjë
3 respekt [REDAKTUAR]. Është e
4 vërtetë, e them me bindje -- edhe jam shumë mirënjohës ndaj
5 atyre personave që sot s'i njoh. Ky është realiteti.

6 E si e kam ndje veten unë aty, s'mund mund ta përshkruaj,
7 veç vetvetja ime mund ta përshkruajë. E kam ndje veten shumë
8 keq. Edhe ai ka qenë vdekja e dytë e imja. Një herë e kam pas
9 një vdekje nga okupatori serb. Kjo ka qenë ma e randë se sa
10 ajo e okupatorit serb, se ka qenë shumë e rëndë për mu të
11 gjendem në një haur, të trajtohem baras me kafshët.

12 Py. Ti personalisht, a u keqtrajtove ndonjëherë fizikisht aty
13 në haur?

14 Pë. Asnjëherë. Asnjë ofendim, asnjë ofendim më të vogël dhe
15 asnjë rrahje a diçka fizike, a kërcënim, s'e kam pas, prej
16 askujt.

17 Py. A ka ndodhur që të të kenë maltrajuar në ndonjë formë, jo
18 të rrahura, po ndonjë lloj forme. Asnjëherë nuk ka ndodhur?

19 Pë. Asnjëherë.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju lutem
21 të shohim dokumentin me numër ERN 06016-TR-ET Pjesa 4, në fund
22 të faqes 1. Në fakt është faqja 2, pra të shohim faqen 2,
23 rreshtat 7 deri te rreshti 10.

24 Py. Pra, prokurori po diskutonte me ty llojet e të rrahurave
25 që ke vëzhguar aty tek të tjerët, por në rreshtin 7 ti ke

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 55

Pyetje nga Z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 thënë:

2 "Po, edhe mua më kanë godit. Më thanë "nxirr duart
3 përpara" dhe nuk më shpjegoi asgjë". Edhe ai të tha që mund të
4 kërkoje ndonjë shpjegim për këtë gjë? Ti thua që nuk i nxora -
5 nuk mund t'i nxirrja duart përpara".

6 A të kujtohet që dikush për të nxjerrë duart përpara?

7 Pë. Është e vërtetë, zoti Prokuror dhe Zonja Gjykatëse, se
8 unë e kam sqaruar këtë shumë mirë edhe nuk e kam marrë
9 maltrajtim ose rrahje. I kam thonë edhe Prokurorit, kur ka hi
10 ai ka qenë -- ka mujt me qenë fëmija im. Ka qenë 17-18 vjeç.
11 Dhe ka thënë "qitni të gjithë duart". Me një shufër druri, një
12 shufër të hollë -- edhe unë i kom qit. M'ka ardh keq, e kom
13 trajtu si fëmiun tim. Ajo s'ka qenë as e rrahun, as -- për mu,
14 mu m'ka ardh keq, qi i ri, qysh është gjet pra nesh. Kjo ka
15 qenë. Është e vërtetë, unë s'e kam marr t'rrahën në goftë se
16 një 18-vjeçar mi ka dhënë dy shufra dore ose tri në dorë. S'e
17 kam ndi kurrfarë - se ai s'ka qenë në gjendje me vlerësu me
18 kokën e vet çka asht ka ban.

19 Kështu jam deklaruar përpara Prokurorit. I kam thanë, më
20 vjen keq prej atij, pse ka qenë shumë i ri edhe sot më vjen
21 keq prej atij, se ai sot në moshë madhore, por më vjen keq se
22 ai e ka bo pa vetëdije atë punë. I vetmi kjo ka qenë gjatë
23 tanë kohës që kam qëndruar aty. Edhe s'e kam marrë këto fare
24 si rrahje ose si kërcënim, ose si diçka tjetër.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund të vazhdoj edhe disa --

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 56
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 të lexoj edhe disa rreshta të tjerë?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
3 po.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

5 Py. Zoti Dëshmitar, Prokurori të ka pyetur nëse edhe të
6 tjerët u rrahën në të njëjtën mënyrë dhe ti ke thënë "Po".
7 Ndodhet në rreshtin 12.

8 Prokurori vazhdon të pyet: "Sa shpesh ndodhte?"

9 "Të gjithë u rrahën"

10 "Po sa herë të rrahën"?

11 Ti the: "Nuk e di, unë jam goditur dy apo tre -- deri në
12 pesë herë, katër apo pesë herë, deri sa nxori zemërimin".

13 Dhe ai të thotë: "Me çfarë të rrahën?"

14 "Me një shkop prej gome" ke thënë ti.

15 "Pra të kanë goditur?" të thotë ai. "Katër-pesë herë?"

16 Ti thua: "Po".

17 Dhe ai të thotë që "Kjo ka ndodhur një herë apo më
18 shumë?"

19 Ti thua: "Një herë. Mbase edhe ndonjë herë tjetër, por jo
20 më shumë se aq, sepse kur hynin ata në haur, ata më thoshin
21 mua "Ti shko te qoshja".

22 Nga kjo që të lexova, duket se ka një kontradiktë me këtë
23 që po thua sot. Thua "ata" në pjesën e parë të kësaj që të
24 lexova. "Ata vazhduan deri sa nxorën zemërimin që kishin
25 përbrenda."

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 57
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Zori Dëshmitar, pasi të lexova këtë pjesë, a mund t'i
2 thuash Trupit Gjykses nëse ishin këta që qëllonin, që
3 godisnin, një apo më shumë, me këtë shkopin e gomës, e trashë
4 prej gome. Sa persona ishin?

5 Pë. Vetëm një. E kam thonë, vetëm një edhe prapë po e them,
6 një herë ka ndodhur. Në atë që e kam thënë unë, m'kanë thonë
7 "shtyu andej". Ka pasur kërcënime me fjalë. Një herë a dy më
8 kujtohet, dy herë ose tre herë sa e kom qenë. Por rrahje ndaj
9 askush s'ka pas. Edhe një herë, [REDAKTUAR]
10 [REDAKTUAR], po rrahje në prezencën

11 time, kurrkujt s'i kanë ba. Sa kam qenë unë aty, brenda për
12 brenda.

13 Py. Por ke thënë, i ke thënë prokurorit atëherë se të tjetër
14 ishin rrahur të paktën një herë më shumë se unë. Ti the "unë
15 jam rrahur një herë po të tjerët janë rrahur të paktën një
16 herë më shumë se unë". A e mban mend këtë?

17 Pë. Jo, unë nuk e mbaj mend se ndoshta jam keqëkuptu, por nuk
18 janë rrahë asnjëherë më shumë as më pak. Një herë -- edhe ajo
19 ka qenë në duar, domethënë nuk ka qenë rrahje, "qite dorën
20 përpara si në shkollë fillore". Nuk ka qenë, as nuk s'ka pas
21 ramje në trup, as në dorë, as në këmbë. Unë e thashë, edhe ai
22 ka qenë shumë i ri, edhe e kam trajue si me qenë fëmiu im. Nuk
23 kom pasur kurrfarë inati, diçka. Më ka ardhur keq peej atij,
24 jo prej vetvetes.

25 Kjo më ka ndodh menjëherë, edhe ajo ka qenë gjithëve,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 58
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 s'ka bën ndonjë dallim as ndaj meje as ndaj -- një person ka
2 qenë.

3 Më shumë -- nuk e a ka qenë gome, apo druri, a nuk -- po
4 ka qenë e lehtë, nuk e kom ndie fare, edhe pse dorën e kom
5 plagosur, nuk kom ndier kurrfarë dhimbjeje.

6 Py. Si t'u dëmtua dora, zoti Dëshmitar? Në ç'kuptim e thua
7 këtë?

8 Pë. Në demonstratat e vitit 1981 kam qenë i plagosur nga
9 okupatori serb. S'mu ka dëmtu aty.

10 Py. A po i thua Trupit Gjykues sot se të vetmet rrahje që i
11 ke parë vetë me sy për të ndaluarit e tjerë është vetëm kjo
12 goditja që ju kanë bërë në duar, që ju kanë thënë "qitni
13 duart" dhe i kanë goditur në duar, apo i ke parë që të jenë
14 rrahur edhe gjetskë, në vend tjetër?

15 Pë. Nuk kam parë hera tjera. Vetëm në duar, këtë çka e kom
16 pae.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të na
18 duhet të lexojmë përsëri një pjesë të deklaratës të
19 dëshmitarit me lejen tuaj.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
21 mundet.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është po e njëjta pjesë, Pjesa
23 4, por i lutem Sekretares të kalojë te faqja 7, në fakt fundi
24 i faqes 6, rreshti 23 dhe pastaj kalojmë te faqja në vijim.

25 Py. Zoti Dëshmitar, vazhdon flitet këtu për rrahjet, zoti

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 59
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Dëshmitar, unë e di që këto nuk janë tema të lehta, zoti
2 Dëshmitar, me fol, me i cek. Do përpigemi që të flasim sa më
3 pak për këto, por për ne është e rëndësishme që ajo që ke
4 përjetuar aty të jetë sa më e qartë për Trupin Gjykues. E di
5 që nuk janë gjëra të këndshme për të folur, por duhet thënë e
6 vërteta.

7 Prokurori të ka thënë:

8 "Po. Po të bëj po të njëjtën pyetje. E ke thënë përpara -
9 - the përpara në fakt që ke parë që -- që mendove që i kanë
10 goditur edhe në pjesë të tjera të trupit.

11 "Pra, në cilat pjesë të tjera të trupit janë goditur ata,
12 i kanë godit?"

13 Edhe përgjigja jote ishte:

14 "Dëgjo. Herën e parë, të gjithë na goditën në duar. Herën
15 e dytë, me sa më kujtohet, goditën [REDAKTUAR]. Mbase e
16 goditën në krah e në shpinë, me sa e di unë edhe ai nga
17 [REDAKTUAR], edhe atë nga Bërrnica e goditën. Dy njerëz, jo më
18 shumë se kaq. Hynë në dhomë për t'i kërcënuar dhe u larguan. I
19 kërcënonin gjithë kohës. Nuk është se hynë për me i rrah".

20 Ta rifreskon kjo kujtesën, zoti Dëshmitar? Sa i takon
21 rrahjes së këtyre viktimave të tjera që janë të ndaluarit e
22 tjerë?

23 Pë. Po. Nuk ka qenë rrahje, po ka qenë e shtymje në shenjë
24 revolte e shtymje - por muri i kanë shty. Se s'ka qenë ndonjë
25 -- unë s'kam parë që ndonjë -- kanë qenë kërcënime, fyerje,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 60
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 sharje edhe të shtyme.

2 Unë faktikisht kam qenë gjithmonë në një qoshe. Kjo ka
3 ndodhur një herë. Por që e kam thënë për [REDAKTUAR] edhe një
4 [REDAKTUAR], nuk ja di emrin. Po prapë nuk e kam marrë atë
5 ndonjë -- se ajo s'ka zgjat as dhjetë - pesëmbëdhjetë sekonda,
6 a njëzetë sekonda. S'ka zgjat kurr gjë jo hiç. Janë hi në
7 shpejtësi, kanë dalë. Janë kërcënu, i kanë shty dhe kanë dalë.
8 Flas për këta, për [REDAKTUAR] dhe këtë [REDAKTUAR]. Për këta
9 të dy.

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 Pë. E vërtetë.

15 Py. Nga momenti që të futën në haur, [REDAKTUAR],
16 deri në momentin që të liruan, rreth datës 18 prill, a të
17 nxorën ndonjëherë jashtë haurit?

18 Pë. Po.

19 Py. A mund t'u thuash Gjykatësve se ku të çuan?

20 Pë. Më -- kam dalë në oborr dhe jemi ngjit lart, ku ishim në
21 haur. Majtas kanë qenë shkallët dhe kemi hipur në katin e
22 dytë.

23 Py. Kush të çoi, të mori e të çoi nga hauri te aty lart?

24 Pë. Një person më ka çu, ka qenë pa maskë fare.

25 Py. Më përpara e kishe parë këtë njeri?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 61
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Jo, asnjëherë.

2 Py. Ishte ditë apo natë?

3 Pë. Jo, ishte mesi i ditës.

4 Py. Je i sigurt që ishte mesi i ditës dhe se ka kaluar shumë
5 kohë edhe --

6 Pë. Po. Se në haur s'kishim -- mund të jetë ose para dite ose
7 mesi i ditës, nuk ka qenë më vonë.

8 Py. Pra, ma merr mendja që të kujtohet që të kujtohet që
9 ishte ditë jashtë, dritë.

10 Pë. Plotësisht. Ishte shumë herët, jo nga mbrëmja. Ishte ose
11 mesi i ditës ose para mesit të ditës.

12 Py. E bëj këtë pyetje se ZPS-së në dokumentin për
13 procesverbalin 06016-TR-ET Pjesa 1, faqe 24, i ke thënë se një
14 natë, një javë pas mbërritjes, të thirrën natën. Prandaj edhe
15 po ta rifreskoj këtë kujtesën. Të kujtohet që i ke thënë ZPS-
16 së që ishte natën?

17 Pë. Çfarë i kam thonë, nuk më kujtohet. Po e di që jam
18 nxjerrë më atë -- një javë a... Nuk ka qenë natë, ka qenë
19 dritë. Tash s'më kujtohet, na orë s'kemi pas aty ta dimë
20 kohën. Kam parë pa oborrin komplet, e kam pa shtëpinë komplet,
21 ka qenë diell ende.

22 Py. Çfarë ndodhi kur shkove lart. A ja përshkruan dot
23 Gjykatësve atë vendin ku hyre?

24 Pë. Kemi hy lart. Ka qenë e shtrume me dërrasa. Ishte një
25 shtëpi, një odë ose dhomë fshatare. Përballë ka qenë një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 62
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 tavolinë, ku kanë qenë tre vetë të ulur. Mbrapa kanë qenë dy -
2 tre vetë, mbrapa shpinës time, dhe unë jam ul.

3 Edhe me t'u ulur, më kanë pyetur [REDAKTUAR], nuk
4 di. Unë me t' thanë të drejtën, e kam marrë si ndonjë lojë të
5 tyre. Por më kanë thanë "kjo është e vërtetë, na trego çfarë
6 [REDAKTUAR]" dhe më [REDAKTUAR] në tavolinë.

7 Kam ndenjur nja 10-15 minuta. Të gjithë kanë qenë jo me
8 maska. Kanë pasur vetëm rrobat e UÇK-së po kanë qenë pa maska.
9 Unë kam menduar se atë ditë do të më lirojnë se nga sjellja
10 njerëzore që e bënë ndaj meje... Mirëpo më kanë thënë se
11 "shumë shpejt do të lirohesh." Dhe ajo "shumë shpejt" ka
12 zgjatur edhe [REDAKTUAR] edhe ma tepër. Domethënë për mu - kam
13 pritur aty që të lirohem. Jo të vazhdoj në atë haur.

14 Më kanë pyetur krejt një -- asnjë sqarim, asnjë akuzë
15 s'ma kanë bo. I vetmi qëllim i tyre ka qenë si po shkon puna
16 nëpër zona të tjera, si është puna [REDAKTUAR]
17 [REDAKTUAR] Dhe me kaq e kemi përfund.

18 Py. Po, që ta kuptojnë Gjykatësit, por edhe unë ta kuptoj më
19 mirë kronologjinë e ngjarjeve, si janë renditur nga ana kohore
20 ngjarjet. The se në atë moment kishe nja [REDAKTUAR] në haur.

21 Pë. Është e vërtetë. Tash, s'muj ta di a ka qenë [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 63
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. Është më se e kuptueshme që nuk të kujtohet numri ekzakt,
2 i saktë i ditëve, por përafërsisht kishe qëndruar në haur deri
3 në atë moment [REDAKTUAR], të themi.

4 Kështu?

5 Pë. Është e vërtetë.

6 Py. Dhe gjatë kësaj kohe a të kishte thënë kush arsyen pse të
7 kishin futur në haur dhe të kishin kyçur aty?

8 Pë. Asnjë arsye, as në haur, as në lart s'ma ka thënë askush.

9 Py. Dhe gjatë kësaj kohe që e kemi diskutuar pra gjerësisht
10 se të kanë -- se të kanë -- gjatë kësaj kohe të kishin treguar
11 ata të tjerët që kishin qenë të mbyllur aty për maltrajtimin
12 që ua kishin bërë, apo jo?

13 Pë. Është e vërtetë, por nuk e kam besuar shumë. Po them me
14 sinqeritetin më të madh, nuk ju kam besuar se nuk -- ishin në
15 gjendje fizike shumë të mirë. Nuk kam vërejtur asnjë shenjë në
16 -- trupin përpos shpinës që e kom thënë, disa vija të
17 mavijosura, a diçka. S'kanë pasur në këmbë, as në duar, as në
18 krye, as në fytyrë, kurrkush s'ka pasur kurrfarë shenje. Bile,
19 me ju thënë të drejtën kanë qenë shumë ma t'shnosh se unë. Se
20 unë si është puna -- e kom ndije, e kom përjetu shumë rëndë në
21 shpirt, e kam përjetu mbylljen aty. Është e vërtetë që më kanë
22 thënë, mirëpo s'kam pasur ide, nuk kanë përmendur emra, asnjë
23 emër s'e kanë përmend kush i ka maltrajtu. As kam pasur
24 njohuri se kush i ka maltrajtu.

25 Py. Më falni, që të ndërpres. Po janë dy gjëra të ndryshme

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 64
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 nëse kanë qenë të maltrajtuar apo kanë qenë në gjendje që t'i
2 identifikojnë ata që i kanë maltrajtuar. Po të kanë thënë, të
3 kanë thënë që ishin maltrajtuar. Kjo a është e vërtetë?

4 Pë. Është e vërtetë që më kanë thënë edhe keq që janë
5 maltrajtu, jo pse --

6 Py. Mirë, në rregull. The se disi nuk po i besojë, por aq
7 maltrajtim që po të tregonin ata, kështu sapo i the
8 Gjykatësve. Kështu? Është e vërtetë?

9 Py. Unë duke u nisur nga vetvetja, sjelljen ndaj meje edhe
10 sjelljen prej që kam shku ndaj atyne personave, të njëjtët
11 fate kemi pas, brenda për brenda. S'ka pas kurrfarë dallimi,
12 as në ushqim, as në ujë, as ne -- se s'kisha pranuar as vetë
13 të dallohem nga ata. Më ka ardhur keq, më ka dhimt në shpirt
14 edhe pse s'i kam njoft. Ndoshta mu kanë mbushur sytë me lot,
15 brenda dite, dy-tre herë, se edhe ata ishin qenie njerëzore,
16 po pse t'ju besojë rrëfimet e tyne, çka ka ndodh, unë nuk isha
17 -- s'kisha iluzione se vetë s'i kisha përjetu, dhe, domethënë,
18 pej momentit ato sjelljet të mira njerëzore edhe ndaj tyne, me
19 përjashtim që thashë dy raste, që kanë ndodh, brenda atyne
20 ditëve. Se sikur të ishim maltrajtu gjatë kohës time dhe që të
21 ishte nxjerrë një njeri, vetëm një person të ishte dërgu diku,
22 të ishte rrah, atëherë kisha fitu përshtypjen se me të vërtetë
23 këta paskan qenë edhe herëve të tjera. Vetë fakti --

24 Py. Pra -

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 65
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 falni, më falni.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

3 Py. Nëse sjelljen e këtyre të ndaluarve të tjerë, shihje
4 diçka që ja rrisnin ose nuk ja rrisnin besueshmërinë e atyre
5 historive që të tregonin për trajtimin që jua kishin bërë?

6 Pë. Jo, pse nuk besoja, sepse asnjëri nuk e kishte rrëfimin e
7 njëjtë. Çdo njëri rrëfente dhe i zmadhonte sendet. Në -- nuk
8 kishte asnjë rrëfim i njëjtë me njëni-tjetrin. Dhe kjo m[ë
9 linte përshtypjen që s'është e vërtetë ato çka ju ka ndodh,
10 çka flisnin ata. Deri sa unë nuk shihja shenja tyne në trup,
11 as në fytyrë, as në kokë, as --

12 Py. Faleminderit. Faleminderit.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për ta
14 mbyllur këtë temë do të doja t'ju lexoja disa rreshta
15 Dëshmitarit, numrin 061016-TR-ET Pjesa 3, në ekrane nëse
16 mundet. Do t'i lexoj dëshmitarit rreshtat 18 deri 22 në faqen
17 6. Në fakt pak më herët, në rreshtin 13.

18 Py. Prokurori të pyeti:

19 "T'i kthehem asaj që na the sa i takon të ndaluarve të
20 tjerë. Pra na the se çdo natë, ose çdo dy net, i çonin lartë
21 dhe ti the "po ishim -- ata ishin të befasuar, dhe të
22 tronditur se si nuk po maltrajtoheshin e jo më pastaj që nuk
23 po maltrajtohesha unë".

24 Pastaj të pyet Prokurori:

25 "Për çfarë të thanë se u kishte ndodhur"?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 66
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 " [REDAKTUAR], edhe [REDAKTUAR], kur vinin hapnin derën.

2 Më afroheshin kaq shumë sa që gati më hynte në gjoks, në
3 kraharor nga frika që kishte prej tyre, duke kujtuar se unë
4 [REDAKTUAR]

5 Pë. Është e vërtetë, se kështu jam deklaruar, edhe ata më
6 llogarisin se si një lloj [REDAKTUAR]

7 Py. Pra kaq shumë frikë kishte [REDAKTUAR]
8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR] aty në haur.

10 Pë. Është e vërtetë.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do të vazhdojmë në tej, të
12 nderuar Gjykatës.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
14 Prokuror, dëshiroj që t'i bëj një pyetje Dëshmitarit në lidhje
15 me këtë.

16 Zoti Dëshmitar, përse disa prej këtyre personave të tjerë
17 që ishin të ndaluar aty në haur, pse, po e them me fjalët e
18 mia, tani, jo si e the ti, pse duhet të të gënjenin apo ta
19 ekzagjeronin për maltrajtimin?

20 DËSHMITARI: Nuk e di ose nga frika se mund të rrahën
21 apet. Kjo ishte ajo, se ata gjithmonë -- ne ishim me strese se
22 mund t'i nxjerrin ose t'i rrahë dikush.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
24 mjafton.

25 Zoti Prokuror, keni fjalën.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 67
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

- 1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara
2 Gjykatëse.
3 Py. Zoti Dëshmitar, do t'i kthehemi momentit kur ishte lart.
4 The se kujtove se lojë po bënin në fillim.
5 Pë. Është e vërtetë.
6 Py. Ajo që desha të të pyes është se pas [REDAKTUAR]
7 [REDAKTUAR] mbajtur aty në haur, pavarësisht se ti s'doje të
8 ishe aty, ku njerëzit të kishin kaq shumë frikë sa që kërkonin
9 [REDAKTUAR] kur hynte dikush në dhomë. Njerëzit që të
10 thanë që i kishin rrahur, ti pastaj pasi i ke thënë edhe
11 Trupit Gjykues se kishe frikë edhe ti vetë për jetën tënde, si
12 mendon, çfarë lloj loje mendon se mund të kishte qenë?
13 Pë. Jo, unë duke ditur se nga një haur ku isha, po të
14 qëndroja edhe ata më [REDAKTUAR], unë e kam mendu se është
15 lojë. Se unë po të [REDAKTUAR], do të më thonin "shko pi
16 shpie". Por ndoshta nuk kanë qenë ata që kanë mujt me m'thonë
17 mu "shko në shtëpi". Mandej, përshtypja ime është se edhe një
18 herë po themi, janë sjellë në mënyrën më njerëzore.
19 Nuk më kanë dhënë asnjë sqarim. Vetëm se më kanë thanë
20 "shumë shpejt, [REDAKTUAR] do të lirohesh". "Shumë shpejt" unë
21 kam menduar atë ditë, ose atë natë do të lirohem.
22 Py. Po a të liruan atë natë, atë mbrëmje, zoti dëshmitar?
23 Pë. Jo. Unë e thashë më -- [REDAKTUAR], unë jam
24 liruar me 18. Tash, 18 a 19, s'më kujtohet, 18 më duket. Po më
25 njeri i gjallë s'ka komunikuar me mu, deri sa jemi liru.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 68
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. Kur ishe lartë, a t'u dha mundësia të flisje?

2 Pë. Po. Kemi fol si me shokë. [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR] dhe ashtu i kam trajtu. Por edhe ata që kanë qenë

6 lart më kanë trajtuar në të njëjtën mënyrë. Kemi bisedu

7 lirshëm edhe si po shkon lufta, si po -- si është gjendja në

8 terren, si çdo gja kemi bisedu.

9 Py. Në fillim të dëshmisë na the se kur kontaktove njerëzit

10 [REDAKTUAR], atyre u kërkove të kontaktonin zotin [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR], që njihej me emrin [REDAKTUAR]. Ti e përshkrove
si [REDAKTUAR].

12 A u përmende këtyre njerëzve kur ishe lart emrin e
[REDAKTUAR]?

13 Pë. Jo, emrin e [REDAKTUAR] e kam përmendur poshtë, kur na e

14 kanë prurë ushqimin, i kam thënë dy vetëve: "Lajmëroni

15 [REDAKTUAR]". Më kanë thënë është i zënë se [REDAKTUAR] vjen,

16 kështu ma ka dhanë përgjigjen. Prit se vjen. Momentalisht, më

17 kanë thanë, është i zënë.

18 Py. Pra nuk e përmende emrin kur ishe lart, pra, nuk u zu në

19 gojë emri i [REDAKTUAR]?

20 Pë. Nuk më kujtohet që a kanë zënë, s'më kujtohet. Ndoshta e

21 kom zënë, po s'më kujtohet, se s'ka ra fjala për të.

22 Se me të thanë të drejtën, kam mendu se po lirojnë, nuk

23 kam pas -- kam prit vetëm lirim.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja

25 me lejen tuaj që t'i lexoja një pjesë tjetër të deklaratës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 69
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
2 mund ta bëni.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Referenca është 061016-TR-ET
4 Pjesa 2, faqja 8. Dhe do të lexoj nga rreshti 7 deri në
5 rreshtin 14.

6 Py. Këtu ke diskutuar me Prokurorin atë kohën që të kanë çuar
7 lartë. Prokurori të ka pyetur:

8 "Çfarë pyetjesh të kanë bërë?"

9 Dhe ti the:

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 A të kujtohet që të kesh diskutuar për këtë?

20 Pë. Po, e vërtetë, por nuk -- unë nuk e di a e kam thënë për
21 lart, unë e kam kërkuar dy herë [REDAKTUAR]. Po me sa di unë
22 është poshtë, e them nga hauri, i kam thënë "[REDAKTUAR]".

23 Ndoshta edhe më ka thanë njëri në një zonë tjetër, është e
24 vërtetë. Por nuk më kujtohet që e kam biseduar lart. Ndoshta
25 edhe lart e kam bisedu, por krejt një herë a dy është që kam

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 70
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kërku [REDAKTUAR], që m'u ka dhënë mundësia ta kërkoj. Edhe
2 është e vërtetë që më kanë thënë "është në një zonë tjetër. Do
3 të vijë, posa të vijë, do të lajmërohet".

4 Py. Dhe më vonë e mësove ti nëse e njoftuan [REDAKTUAR] që ti
5 mbaheshe i ndaluar aty në atë vend?

6 Pë. Po. E kam mësuar. Se s'e kanë njoftuar fare. Kur i zoti i
7 shtëpisë ku kam qendru -- se ata e kanë dit në oborr është
8 bisedue që [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR], edhe të nesërmen kanë shku te [REDAKTUAR], e kanë
10 taku dhe ai ka thënë "unë lidhje me këtë punë nuk di asgjë".

11 Edhe pas një kohe, u bisedu personalisht me [REDAKTUAR]
12 dhe jam i bindur që lidhje me atë punë [REDAKTUAR] s'ka pas.

13 Se [REDAKTUAR]. S'ka pasur lidhje me -- po

14 është e vërtetë që kanë komunikuar me [REDAKTUAR]. Të nesërmen
15 me 5 prill në Zllash e kanë taku. [REDAKTUAR], me dy-tre

16 vetë të tjerë kanë qenë edhe [REDAKTUAR], që i kanë qenë

17 bashkë, edhe kanë kërkuar llogari nga [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]

18 i ka thonë "unë nuk kam lidhje me këtë punë. Këqyrni në Zllash
19 kush mund të kryejë punë".Ky ishte sqarimi i [REDAKTUAR].

20 [REDAKTUAR]

21 Py. Faleminderit. Kur thua që është e vërtetë që e kanë
22 takuar dhe kanë folur me [REDAKTUAR], e ke fjalën për familjen
23 ku ndejte ti në fillim apo për ata që të kapën?

24 Pë. Jo, jo, për familjen ku qëndrova. Ata kanë shku -- ata --
25 pse te ne është traditë me ja marr mikun nga shtëpia asht e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 71
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 rëndë.

2 Py. Faleminderit, zoti Dëshmitar.

3 Për sa i takon njerëzve që ti pe lart, kur të ngjitën
4 lart, a i njihje ti ata, ndonjërin prej tyre, njihje?

5 Pë. Asnjë. Jua them me bindje të plotë, as një se kam njoft.

6 Py. A ishin të veshur me uniforma?

7 Pë. Me uniforma, po, por me fytyrë kanë qenë pa maska. Unë po
8 them, kanë qenë të lirë me mua, kemi biseduar [REDAKTUAR]
9 [REDAKTUAR] Për çështjen aktuale, nuk kemi hap
10 tema të tjera, as arsyen pse jam unë aty, as hiç se s'kam
11 kërku prej tyre. Unë kam menu se po m'lirojnë atë ditë.

12 Py. A të thanë ata ty që është bërë një gabim?

13 Pë. Është e vërtet, po ka thanë [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR] Me kaq e kemi përfundu bisedën e
15 fundit.

16 Py. Po ti e besove se në fakt ishte bërë gabim? Fjalët e tyre
17 ishin të vërteta mendove?

18 Pë. Por mendoj që edhe sot ata njerëz e kanë marrë ndonjë

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR] mu do të më lironin atë ditë. Nuk ka qenë në
23 kompetencën e tyre.

24 Dhe sot e kam këtë përshtypje, që po të -- ata njerëz që
25 kam pi kafe e kom pi cigare, dhe n'mënyrë ma njerëzore kom

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 72
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 bisedu dhe m'kan prit, po të kishin pas forcë ose diçka në
2 dorë, më kishin liru mrena dite.

3 Domethënë, këtu ekziston individi që ka dhanë urdhër.

4 Py. Zoti Dëshmitar, ti the se nuk i njihje këta njerëz.

5 Kështu the?

6 Pë. Është e vërtetë.

7 Py. The gjithashtu, - Prokurorit atëherë - dhe kjo gjendet në

8 faqen 8, te faqja ku jemi, te rreshti 18, 19, [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR] I qëndron kësaj gjëje?

10 Pë. Si ti besoj, kur shkova në haur apet?

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 Py. Si u ndjeve kur bisedove me ata njerëzit lartë? U ndjeve

17 sikur po flisje [REDAKTUAR] sikur se the deri

18 tani?

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju lutem

24 më paraqisni në ekran Pjesën 5 të transkriptimit, faqen 9, të

25 tregohet pra, të paraqitet në ekran. Dokumenti ka numër 06016-

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 73
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 TR-ET.

2 Py. Zoti Dëshmitar, te rreshti 14 Prokurori të ka pyetur:

3 "Duke qenë që ke ndenjur gati një orë në shoqërinë e tyre
4 dhe fytyrat e tyre ishin të zbuluara, mendon se mund të
5 njohësh ndonjërin prej tyre sot?".

6 Ti the:

7 "Unë nuk i njihja as pas tre muajsh, lëre më mbas gjithë
8 këtyre viteve".

9 Prokurori të pyeti:

10 "Përse jo?"

11 Dhe ti ke thënë:

12 "Ishim gjysmë të vdekur e gjysmë të gjallë. Pra kishim
13 përshtypjen se nuk do të dilnim gjallë prej andej".

14 Dhe pastaj vazhdon se si nuk kishe informacion, se si
15 kishe lënë familjen.

16 Më duket, nga këto fjalë, se situata që i ke përshkruar
17 Prokurorit atëherë, nuk është ajo që po na thua tani, që ishin
18 njerëz që [REDAKTUAR] dhe
19 që nuk i mban mend. Me një fjalë, nuk janë -- nuk është e
20 njëjta gjë.

21 Pë. Unë kur e kam thënë zotit Prokuror, edhe Prokurorit,
22 ishim njerëz gjysëm të gjallë gjysëm të vdekur, e kom thonë
23 para se të mbërrij lart. Unë edhe një herë po shprehem,

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR] E vetë fakti që ata më [REDAKTUAR], unë e thashë -

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 74
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 - edhe një herë e kam mendu që që i farë loje, dhe m'kanë
2 [REDAKTUAR], në prezencë të të gjithëve, [REDAKTUAR], kam
3 ndejtë një orë. Unë nuk di si me i trajtu ata njerëz kur as
4 një ofendim, asnjë -- çdo gjë ka qenë për kauzën kombëtare,
5 edhe si po shkon rrjedhat në zonat e luftës. Unë i kam pyet,
6 edhe ata kanë qenë të rrezikuem, jo vetëm në mbrena që kemi
7 qenë në haur, po edhe ata kanë qenë të rrezikum, të sulmohen
8 nga okupatori serb në çdo moment aty në Zllash. Domethënë as
9 ata nuk e kanë pas jetën të sigurt, qëndrimin e tyre aty për
10 aty.

11 Prokurorit i kam thënë, "nuk i kam njoftë mbas tre
12 muajve". Po të kisha bindje ta përcillja dikënd ose të kisha
13 mendu që ndonjëri është fajtor prej tyre, do ta perceptoja sot
14 në tru. Unë ju garantoj me jetë, ndoshta ai që ka dhënë urdhër
15 që të burgosem në Zllash [REDAKTUAR] iks herë me mua në
16 Prishtinë, e unë s'e njoh. Edhe paraqitet si mik i imi. Edhe
17 ata njerëz, që them [REDAKTUAR], unë e
18 nisa nga ndjenja ime. Ata [REDAKTUAR]
19 [REDAKTUAR]. Tjetër çka kanë mendu ata. Une e kom pas
20 konceptimin që ata po [REDAKTUAR].

21 Edhe pse të kem arsye unë po t'i njoh, të them s'i kam
22 njoft. Nuk kam ardh këtu me mbrojt askënd. Edhe një herë po
23 deklaroj.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I the
25 ato që duhej, faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 75
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, të
2 paraqesim pjesën e parë të transkriptimit në ekran, faqja 28,
3 rreshti 4 deri në 6.
4 Py. Zoti Dëshmitar, po vazhdojmë me këtë pjesë sepse
5 përshkrimi që po na bëni tani, të bisedës miqësore, bie ndesh
6 plotësisht me këtë që ke thënë atëherë. Pra, sigurisht është e
7 qartë që flet për kohën që ke qenë lart. Por gjatë
8 intervistës, në vende të tjera ke thënë gjëra që nuk pajtohen
9 plotësisht me përshkrimin që po i bën bisedës miqësore lart
10 deri tani. Për shembull, ty të ka pyetur Prokurori, në
11 rreshtin 4, a ja u ke parë fytyrat?

12 Ti thua: "Jo, sepse nuk ndjehesha normal. Unë me sa
13 shikoja unë, më dukeshin sikur ishin hije."

14 Më duket, nga këto fjalë zoti Dëshmitar, se ke qenë shumë
15 i frikësuar, i shqetësuar, dhe nuk ishe një njeri që
16 [REDAKTUAR], siç na thua deri tani. A nuk
17 të duket edhe ty kështu?

18 Pë. Është e vërtetë, se në fillim, kur -- m'u kanë duk si
19 hije. Edhe kur deklarova edhe para Gjykatësës, kur më
20 [REDAKTUAR], nuk kam pasur besim, kam mendue se është ndonjë
21 lojë. Por kur vërtetë, [REDAKTUAR], më kanë
22 thënë: "[REDAKTUAR]", kështu më kanë thënë.
23 "nuk e kemi ndërmend -- [REDAKTUAR], iher nga vëllezërit e tu"
24 atëherë e kom kuptu se me të vërtetë nuk është fare lojë. Se
25 po të kishin ndonjë lojë, s'do të [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 76
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Edhe një herë, kur e kam thënë "ishim gjys të vdekun" nuk mund
2 t'i perceptonim fytyrat e askujt. Unë nuk kisha idenë me
3 perceptu dikan në atë gjendje çfarë isha. Po me ata lart kam
4 bisedu dhe jam liru dhe e kom bisedu edhe një herë po
5 deklarohe, edhe sot i falënderohem, si me i pas anëtarët e
6 familjes ose sikur me qenë vëllaznit e mi. Se janë sjellë në
7 mënyrën ma korrekte, ma njerëzore, mrena ni ore që kam qenë me
8 ta.

9 Se po të dyshoja që njëri prej tyne, brenda atyne pesë -
10 gjashtë vetëve sa kanë qenë, është fajtor, unë do të
11 deklarohe këtu. Por edhe një herë e kam bindjen, zonja
12 Gjykatëse dhe Prokurori, bindjen e plotë që [as] njeri brenda
13 Zllashit e atij burgut nuk është fajtor për burgosjen time.
14 Është jashtë burgut. E them me përgjegjësinë më të madhe
15 njerëzore edhe kombëtare dhe familjare.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
17 Dëshmitar.

18 Zoti Dëshmitar, nuk ke nevojë t'i përsërisësh fjalët. E
19 the më përpara këtë dhe më duket se është hera e psetë që po e
20 thua. Ne e kemi mbajtur shënim këtë që the. E kemi parasysh.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim]
22 Py. Ti the se kur të çuan lart, askush nuk të kishte treguar
23 se pse të kishin burgos. Këta njerëzit që [REDAKTUAR] lart,
24 a të dhanë ndonjë shpjegim se pse të kishin mbajtur aty?
25 Pë. Zoti Prokuror, po përsëritet edhe një herë e njëjta

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 77
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 pyetje. Unë aty nuk mora asnjë sqarim pse jam, e kam thonë dhe
2 e thash edhe ma herët. Të vetmin sqarim që mora se [REDAKTUAR]
3 [REDAKTUAR] dhe do të lirohem shumë shpejt. Ky ishte sqarimi
4 im që e dhashë.

5 Py. Kishe [REDAKTUAR] pa vajtur në shtëpi. A ju
6 kërkove atyre që të kontaktoje familjen?

7 Pë. Unë nuk dija fare, familjen ku e kisha. Familja ishte
8 [REDAKTUAR] Një ditë pa u burgosun e mora vesh se familjen e
9 kanë shpërngulur nga Prishtina dhe familja [REDAKTUAR],
10 dikun, si e largume dhe nuk kisha ide ku asht, çka asht, a
11 asht gjallë, a asht n'rrugë. Veç e dija që e ka largua policia
12 serbe, ju ka hi në shtëpi dhe i ka largu nga shtëpia. Edhe
13 përputhet, një ditë manej unë burgosem në Zllash. Unë e kisha
14 brengën e familjes. Se kisha lënë [REDAKTUAR]
15 [REDAKTUAR].

16 Py. Po mirë, po i pyete apo jo, ju kërkove apo jo atyre që të
17 kontaktoje familjen, megjithatë?

18 Pë. Po s'kishte shans teorik, kujt t'i kërkoje?

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do t'i kthehem përsëri kësaj
20 teme, sepse përmenda një referencë të gabuar, po do t'i
21 kthehem përsëri.

22 Py. Pra, çfarë ndodhi në fund të bisedës, mbasi mbaruat?

23 Pë. Mbasi mbaruam, erdhi i njëjti person që më çoi lart, më
24 mori dhe më çoi në -- aty ku ishim në ahër, [REDAKTUAR].

25 Py. Dhe nëse të kuptova drejt, the që ndenje edhe nja një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 78
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [REDAKTUAR] pas kësaj. Kështu?

2 Pë. E vërtetë.

3 Py. Nga momenti që të sollën përsëri në ahër, deri sa të
4 liruan, a të nxorën ndonjëherë tjetër jashtë nga ai ahri?

5 Pë. Asnjëherë.

6 Py. Po të tjerët që ishin me ty? Një minutë ta mbaroj pyetjen
7 të lutem.

8 Pë. Asnjëherë. [E pakuptueshme].

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Zonja Kryetare e Trupit
10 Gjykues, e shikoj që kanë mbetur edhe gjashtë minuta para se
11 të mbaroj dhe unë do të kaloj në një temë tjetër. Nuk e di
12 ç'mendoni, a është e mundur që ta fillojmë pushimin tani dhe
13 të rifillojmë temën e re pas drekës, pas pushimit të drekës?

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Sekretare, të lutem të kalojmë në seancë publike dhe është
16 koha e përshtatshme për të bërë pushimin.

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Zoti Dëshmitar, tani është koha e pushimit të drekës. Do
22 të rifillojmë përsëri në orën 14.25 minuta. Shpresoj që të
23 keni mundësi të pushoni pak mbas dëshmisë. Do të shikohemi
24 përsëri më pas.

25 Tani Sekretarja do të të shoqërojë të dalësh nga salla e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 79
Pyetje nga Z. De Minicis
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 gjyqit.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
4 rifillojmë në 14.25. Këtu përfundon.

5 --- Pauza e drekës filloi në orën 12.56 pasdite

6 --- Seanca rifillon në orën 14.59 pasdite

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
8 sekretare -- po patjetër. Të pranishmit sot mbasdite shoh që
9 janë po të njëjtët persona në të dyja anët.

10 Mirë, zonja Sekretare, të kalojmë në seancë private të
11 lutem.

12 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
14 jemi në seancë private.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Faleminderit.

17 Ka pasur një kërkesë nga Mbrojtësja e Viktimave për një
18 seancë ex-parte. Trupi Gjygues ka vendosur ta miratojë
19 kërkesën që do të thotë se do të bëhet sot pasdreke.

20 Fatkeqësisht, në fakt duhet paksa kohë për ta organizuar

21 sallën në atë mënyrë që të organizohet një sesion ex-parte

22 kështu që kjo do të thotë se siç i shoh gjërat nuk do të

23 vijojmë dot me vazhdimin e dëshmisë së dëshmitarit sot

24 pasdreke dhe kur të kalojmë në seancë publike, janë disa

25 çështje të cilat i kisha bërë ndërmend t'i diskutoja në fund

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 80

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 të seancës sot, kështu që do t'i diskutoj tani publikisht,
2 megjithëse duhet të vazhdoj të qëndroj në seancë private edhe
3 paksa.

4 Shoh që Prokurori është ngritur në këmbë.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Kërkoj
6 më shumë sqarime ju lutem sa i takon kësaj seancë ex-parte.
7 Mbase do të jetë një seancë ex-parte më pas, por nuk e di nëse
8 Trupi Gjykses ka vendosur që të vijojë me marrjen në pyetje të
9 dëshmitarëve gjatë seancës ex-parte. Ju kërkoj ndjesë nëse s'e
10 kuptova qartë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Kërkoj ndjesë që nuk isha unë e qartë, Zoti Prokuror.

13 Mbrojtësja e Viktimave ka bërë një kërkesë, nuk mund ta them
14 për çfarë, por është e rëndësishme që të bëhet përpara se të
15 vijojmë me bërjen e pyetjeve, me vazhdimin e pyetjeve për këtë
16 dëshmitar 3954.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit shumë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull atëherë. Do ta informoj dëshmitarin se duke pasur
20 parasysh orën, nuk mund të vazhdojmë me dëshminë e tij sot. Do
21 të rikthehem tani në seancë publike, gjatë së cilës dëshiroj
22 që të diskutoj disa çështje. Zonja Sekretare, të kalojmë në
23 seancë publike, të lutem.

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

1 jemi në seancë publike.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, zonja Sekretare.

4 Së pari është një çështje të cilën dëshiroj që ta
5 diskutoj me Prokurorinë. Ka të bëjë me rendin e dëshmitarëve
6 për muajin nëntor dhe dhjetor dhe një ndryshim të mundshëm të
7 këtij rendi. Trupi Gjykses vëren parashtrimin e ZPS-së mbi
8 rendin e rishikuar të dëshmitarëve për muajt tetor, nëntor dhe
9 dhjetor që është parashtrimi i protokolluar 229. Jemi
10 informuar si Trup Gjykses nga Zyra Administrative se gjatë
11 muajve në vijim nuk do të jetë e mundshme të zhvillojmë sesion
12 të katërt gjatë ditës, në secilën ditë. Prandaj Trupi Gjykses
13 do të mund të dëgjojë dëshminë e vetëm një dëshmitari në javë.
14 Nëse koha e vlerësuar nga ZPS-ja për pyetjet kryesore nuk
15 është më shumë se dy orë për dëshmitar. Në këtë rast, në një
16 javë mund të dëgjoreshin dy dëshmitarë të tillë.

17 Por, duke parasysh që dy dëshmitarë duhen dëgjuar së
18 bashku, Trupi Gjykses propozon të ndjekë rendin e propozuar
19 nga ZPS-ja, me përjashtim të dëshmitarëve 4391, 4390 dhe 4676.
20 Propozimi i Trupi Gjykses është propozim, sepse duhet të
21 shikojmë edhe disponibilitetin dhe arsyet e tjera, është që të
22 dëgjohet dëshmia e dëshmitarit 4676 në periudhën 17-19 nëntor
23 2021 dhe dëshminë e dëshmitarëve 4391 dhe 4390 në periudhën 22
24 deri në 26 nëntor. Arsyeja për këtë ndryshim të propozuar
25 është se në javën e 22 nëntorit, Trupi Gjykses ka në

1 dispozicion, siç i është komunikuar palëve dhe Mbrojtëses së
2 Viktimave, -- kemi më shumë pra se tre ditë radhazi për të
3 dëgjuar dëshmitarët. Pra nëse duhet të dëgjojmë dy dëshmitarë
4 pra në këtë rast, do të na duhet më shumë disponibilitet duke
5 mbajtur parasysh edhe numrin e propozuar të orëve të bërjes së
6 pyetjeve dëshmitarit nga ZPS-ja.

7 Për shkak të caktimit të orëve të kohës për seanca
8 gjyqësore të dëshmitarit 4485, me shumë ngjasë do të caktohet
9 të dëshmojë në periudhën 13-15 dhjetor, dhe dëshmitarët 4601
10 dhe 4484 me shumë gjasë do të japin dëshmi në janar të vitit
11 2022.

12 Nuk pres që të reagoni në vend tani, por ky është hë për
13 hë propozimi im konkret në lidhje me tre dëshmitarët.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
15 Gjykatëse, i mbajtëm shënim.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull.

18 E dyta gjë që dëshiron të diskutojë Trupi Gjygues
19 gjithashtu ka të bëjë me ZPS-në. I lutem zonjës Dekretare që
20 të kalojmë në seancë private.

21 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
23 jemi në seancë private.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Faleminderit, zonja Sekretare.

1 Kjo ka të bëjë me dëshminë e dëshmitarit 1679. Kemi vënë
2 se në listën e materialeve për t'u përdorur me dëshmitarin,
3 është një dokument që është një shënim zyrtar i ZPS-së, do
4 t'ju citoj numrin e ERN-së që është 060690-060698-ET-RED, në
5 faqet nga 060695 deri në 060697 të këtij dokumenti, ka një
6 përkthim anglisht të deklaratës origjinale të UNMIK-ut me këtë
7 dëshmitar, që duket se përfshin një korrigjim të tekstit të
8 deklaratës origjinale të UNMIK-ut që e ka bërë dëshmitari
9 gjatë intervistës me ZPS-në me [REDAKTUAR]. Ndërsa në
10 deklaratën origjinale të UNMIK-ut përmendet se dëshmitari e
11 mori vesh të nesërmen se [REDAKTUAR] ishte vrarë, në
12 përkthimin e ZPS-së të datës [REDAKTUAR] thuhet se dëshmitari
13 e mori vesh, pra e mori vesh, pa përcaktuar një moment kohor
14 se [REDAKTUAR] ishte vrarë.

15 Duam të dimë nëse e kemi kuptuar saktë nëse është bërë
16 një korrigjim, apo nëse është problem në përkthim. Sepse nuk e
17 kemi ende të qartë këtë gjë.

18 Trupi Gjykses vëren më tej se përkthimi në anglisht i
19 ZPS-së i [REDAKTUAR] ndryshon nga origjinali i deklaratës së
20 UNMIK-ut që është me numër ERN 7000687-7000691RED3, duke e
21 përcaktuar më tej SITF00035217, ku përkthimi ndryshon me
22 përcaktimin me një vend "kati i dytë" në rastin tjetër "kati
23 lart" ose "lart". Trupi Gjykses i kërkon ZPS-së të sqarojë
24 arsyen për këto dallime. Edhe një herë nuk ka nevojë të
25 reagoni në vend sot, por ju kërkojmë, mjafton pra që të na

1 jepni shpjegim me shkrim këtë javë.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, ka gjasë
3 që t'ju shpjegohemi nesër lidhur me këtë problem.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më në
5 përgjithësi, kemi vënë re që në shënimin zyrtar të ZPS-së, apo
6 lidhur me këtë, do t'ju luteshim që, nëse është e nevojshme,
7 të kemi edhe një shënim, një shpjegim që shoqëron këtë shënim
8 zyrtar të ZPS-së, për të shpjeguar se çfarë është ky shënim
9 zyrtar. Se vumë re që është një dokument, për shembull, është
10 përkthimi zyrtar i deklaratës së UNMIK-ut që nuk përmendej në
11 shënimin zyrtar tuajin. Ne thjeshtë e gjetëm duke parë.

12 Po kështu, ky shënim shoqërues i shënimit shpjegues të
13 përfshijë edhe referencën, me cilën pjesë përkatëse të
14 deklaratës së UNMIK-ut ka lidhje, me cilët pjesë të
15 intervistës kanë lidhje, sepse ne na u desh të shikojmë
16 intervistën për të parë se me cilët lidhen.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
18 Gjykatëse, ju falënderojmë për mundësinë që na jepni për ta
19 sqaruar këtë. Nesër do t'ju japim sqarimet e kërkuara.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit. Zonja sekretare, të kalojmë në seancë publike.

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
24 jemi në seancë publike.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Tani Trupi Gjykues dëshiron që të trajtojë një çështje
3 për palët dhe Mbrojtësen e Viktimave. Në përgjithësi, Trupi
4 Gjykues u lutet palëve dhe Mbrojtëses së Viktimave që sa herë
5 të paraqesin materiale si prova, të tregojnë edhe nivelin e
6 klasifikimit të materialit në fjalë. Konkretisht, palët dhe
7 Mbrojtësja e Viktimave duhet të bëjnë përpjekje për të treguar
8 se cilat materiale, nëse ka, mund të klasifikohen si publike
9 nëse do të konsiderohen si të pranuar.

10 Lidhur me këtë, lëshoj këtë urdhër gojarisht për ZPS-në.

11 ZPS-ja ta informojë Trupin Gjykues jo më vonë se dita e
12 premte, më 12 nëntor të vitit 2021 se cilat materiale të
13 përfshira në parashtimin e protokolluar 201, përfshirë edhe
14 materialet e përmendur nga i akuzuari në intervistën e tij me
15 ZPS-në, mund të klasifikohen si publike nëse ka, dhe nëse do
16 të konsiderohen si të pranuar.

17 Gjithashtu, ZPS-ja të bëjë të ditur jo më vonë se data 15
18 tetor 2021 se cilat materiale të përfshira në parashtimin e
19 protokolluar 228 mund të klasifikohet si publike nëse ka dhe
20 nëse do të konsiderohen si të pranuar. Këtu mbyllet ky urdhër
21 i lëshuar gojarisht.

22 Ka edhe një gjë të fundit edhe kjo ka të bëjë me ZPS-në.

23 Pas kërkesës së ZPS-së për ri klasifikim të parashtimit të
24 protokolluar 230, Trupi Gjykues ka dhënë urdhër për
25 riklasifikimin si konfidenciale të katër parashtimeve të

1 protokolluar që ZPS-ja identifikon në atë material.

2 Sipas të njëjtit arsyetim, Trupi Gjykues synon që
3 gjithashtu të ri klasifikojë si konfidenciale listën e
4 ndryshuar të dëshmitarëve të ZPS-së, që është shtojca 1 e
5 parashtrimit të protokolluar 161, që tani është e klasifikuar
6 si rreptësishtë konfidencial dhe ex-parte.

7 Lidhur me këtë, do të lëshoj një urdhër gojarisht për
8 ZPS-në por po shoh që po tundni kokën, doni të thoni diçka
9 tani?

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi
11 kundërshtim për këtë riklasifikim.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Atëherë do të urdhërojmë ri klasifikimin në këtë kuptim.

14 Hë për hë kaq kishim. Do ta ndërpresim seancën parimisht
15 deri nesër në mëngjes në orën 09.30 minuta, pra sot nuk do të
16 vazhdojë dëshmia e dëshmitarit 3594. Ngaqë jemi në seancë
17 publike, falënderoj palët dhe Mbrojtësen e Viktimave dhe Zyrën
18 Administrative. Jo, nuk kemi nga Zyra Administrative të
19 pranishëm. Kërkoj ndjesë, për praninë e tyre. Falënderoj
20 përkthyesit, hë për hë edhe stenografen dhe personelin e
21 sigurisë për ndihmën e dhënë sot. Këtu ndërpresim seancën.

22 --- Seanca mbyllet në orën 15.15 pasdite

23

24

25